

**RAPORT**  
**MBI VLERËSIMIN E PROCESIT TË ZBATIMIT TË NISMËS**  
**“SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE**



*Aktivitet për ditën Ndërkombëtare të Romëve (8 prill, 2015) në Shkollën 9-vjecare Yzberisht, në kuadër të SHQK*

Tetor, 2015

Ky dokument është mundësuar nga UNICEF si pjesë e programit të përbashkët të MAS dhe UNICEF. Raporti reflekton pikëpamjet dhe mendimet e autorëve të tij dhe jo domosdoshmërisht ato të organizatës. UNICEF nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për mënyrën sesi ky informacion mund të përdoret nga të tjerët.

TIRANE, 2015



**RAPORT**  
**i përgatitur nga**  
**Albanian Social Services Association (ASSA)**



**Grupi i punës**

Dr. Livia Nano

Dr. Blendi Ceka

Prof. Dr. Nikoleta Mita

## FALENDERIME

*Falenderime dhe mirënjohje e veçantë shkon për Gerti Janajin (IZHA), Tatjana Vucani (MAS), Albana Markaja (IZHA), Mirlinda Bushati (UNICEF) dhe Brisida Jabaj (World Vision) për mendimet e vjera, feedbacku-n dhe materialet dhe dokumentacionet e vlefshme që na kanë ofruar.*

*Ky studim nuk do të ishte realizuar pa mbështetjen e koordinatorëve të SHQK në DAR-ZA e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Përmentit, Tropojës, Dibërës, Shkodrës dhe Vlorës të cilët lehtësuan organizimin e vlerësimit në zonat përkatëse.*

*Gjithashtu, i shprehim mirënjohjen tonë të gjithë drejtuesve të shkollave, mësuesve, nxënësve dhe prindërve të intervistuar gjatë fokus grupeve dhe intervistave të cilët ndanë kohën dhe opinionet e tyre duke kontribuar kështu në kuptimin më të mirë të situatës aktuale dhe në dhënien e sugjerimeve për përmirësimin e saj.*

*Së fundi, dëshirojmë të falenderojmë Ervin Kociun, Sevi Xhaferi, Sulltuna Aliaj dhe Vilma Imeraj të cilët me përkushtim u angazhuan në mbledhjen dhe zbardhjen e të dhënave.*

## TABELA E PËRMBAJTJES

- 1. Përmbledhje ekzekutive**
- 2. Vështrim i përgjithshëm për projektin “Shkolla si qendër komunitare”**
- 3. Metodologjia e vlerësimit**
  - 3.1 Qëllimi i vlerësimit
  - 3.2 Metodologjia e vlerësimit
  - 3.3 Burimi i të dhënave
- 4. Konceptimi i projektit “Shkolla si qendër komunitare”**
  - 4.1 Baza teorike
  - 4.2 Akte nënligjore
  - 4.3 Baza institucionale
- 5. Gjetje nga zbatimi i deritanishëm i SHQK**
  - 5.1 Kriteret e përzgjedhjes së shkollave
  - 5.2 Mbështetje për nismën
  - 5.3 Terminologjia që lidhet me SHQK
  - 5.4 Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i konceptit të shkollës si qendër komunitare
  - 5.5 Zbatimi në praktikë i standardeve të SHQK
    - 5.5.1 Statusi aktual i zbatimit në praktikë të standardeve të SHQK
    - 5.5.2 Statusi aktual i angazhimit të aktorëve të ndryshëm në iniciativë
  - 5.6 Procesi i transformimit të shkollës në një qendër komunitare të vërtetë
    - 5.6.1 Infrastruktura
    - 5.6.2 Pretendimi për mbështetjen financiare për realizimin e aktiviteteve
    - 5.6.3 Shkollat SHQK në kërkim të bashkëpunimeve që mbështesin realizimin e aktiviteteve
    - 5.6.4 Paqartësi përsa i përket pagesës dhe normës
    - 5.6.5 Ngarkesa lidhur me raportimet
    - 5.6.6 Nevoja për trajnime të vazhdueshme
    - 5.6.7 Mekanizmi i propozimit dhe planifikimit të aktiviteteve
    - 5.6.8 Koha përgatitore për aktivitetet
    - 5.6.9 Koha e realizimit të aktiviteteve
    - 5.6.10 Bashkëpunimi dhe marrëveshjet ndërinstitucionale
    - 5.6.11 Përfshirja dhe motivimi i mësuesve
    - 5.6.12 Përfshirja e prindërve dhe komunitetit
    - 5.6.13 Përfshirja e nxënësve
  - 5.7 Përfshirja e grupeve vulnerabël
- 6. Rekomandime**
- 7. Referenca**

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shkolla si qendër komunitare është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2013 dhe aktualisht 184 shkolla janë pjesë e kësaj nisme. UNICEF i cili është partner në këtë ndërmarrje është interesuar të bëjë një vlerësim për ecurinë e deritanishme të nismës me synim sjelljen e përmirësimeve dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vlerësim është realizuar duke mbajtur parasysh tre qëllime:

1. Të prezantojë një tablo të ecurisë së nismës;
2. Të identifikojë arritjet e deritanishme, sfidat dhe vështirësitë për zbatimin e kësaj nisme;
3. Të formulojë rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për përmirësimin e kësaj nisme bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare.

Pyetjet rreth të cilave është kryer vlerësimi janë:

- Sa dhe si është kuptuar nisma nga mësuesit, drejtuesit e shkollave, koordinatorët, nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit për SHQK dhe sa janë ndërgjegjësuar ata për këtë nismë?
- Si i kanë përmbushur shkollat standardet e SHQK?
- A e mbështet SHQK arsimin gjithëpërfshirës dhe nxënësit më vulnerabel?
- Cilat janë disa nga arritjet e deritanishme, sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e kësaj nisme?
- Cilat janë rekomandimet që mund t'i jepen MAS dhe politikëbërësve për ta përmirësuar këtë nismë?

Është kryer vlerësim i procesit, i tipit formues. Vlerësimi është bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore. Informacioni parësor është mbledhur në 33 shkolla, përkatësisht në nëntë rajone të vendit: Tropojë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Përmet, Tiranë, Elbasan dhe Korçë. Janë kryer intervista dhe fokus grupe me 108 mësues dhe drejtues, 100 nxënës, 52 prindër, si edhe 11 përfaqësues të SHQK në nivel DAR/ZA dhe në nivel qëndror. Është kryer analiza e përmbajtjes së dokumenteve zyrtare mbështetëse të nismës. Vlerësimi është bërë duke patur si pikë referimi Standardet e SHQK.

Në përgjithësi, nisma SHQK, është mirëpritur pozitivisht në shkollat ku ajo po zbatohet. Në secilën shkollë janë organizuar një sërë aktivitete të cilat kanë krijuar një dinamikë të re pozitive. Kjo dinamikë e re reflektohet nga të gjitha grupet e intervistuar. Ndikimi i aktiviteteve të realizuara si tek mësuesit, nxënësit prindërit dhe komuniteti është i ndryshëm në shkolla të ndryshme. Ka një seri aktivitete të konceptuara mirë, të cilat kanë patur një jehonë pozitive tek të gjitha palët. Ideja e SHQK-së jo vetëm ka ndikuar pozitivisht për një ndërveprim më cilësor mes palëve, por dhe ka nxitur ide dhe projekte të mësuesve, nxënësve dhe shkollave të ndryshme.

Por gjithashtu vihet re se nisma është përqëndruar më tepër në veprimtaritë jashtëshkollore të nxënësve; ka nevojë për një të kuptuar më të mirë lidhur me rolet e partnerëve në këtë nismë; ka një sërë sfidash që lidhen me angazhimin e mësuesve, burimet financiare dhe unifikimit të terminologjisë. Po ashtu vërehet se nevojiten materiale të tjera ndihmëse dhe mbështetëse të procesit në praktikë.

Nisma mbështetet nga një dokumentacion teorik, akte nënligjore dhe udhëzime praktike.

Bazuar në gjetjet e këtij vlerësimi, janë paraqitur një sërë rekomandimesh që lidhen me fokusin e nismës, me përmirësimin e funksionimit të SHQK, me përgjegjësitë e MAS dhe të IZHA-s. Besojmë se mësimet e nxjerra nga zbatimi fillestar i nismës do të ndihmojnë për të bërë përmirësimet e duhura dhe për të përmbushur synimet e parashikuara.

## **2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR PROJEKTIN “SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE”**

Shkolla si qendër komunitare është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2013 me qëllim për të ridimensionuar dhe përmirësuar cilësinë dhe rolin e shkollës dhe sistemit arsimor shqiptar, jo vetëm në komponentin e mësimdhënies dhe të nxënësve, por edhe për hapjen e shkollës ndaj komunitetit. Nisma “Shkolla si qendër komunitare” shikohet si një mundësi për sigurimin e një arsimit cilësor për çdo nxënës, si një mundësi për kultivimin e vlerave demokratike, sigurimin e mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve, angazhimin dhe zhvillimin e komunitetit, si një mundësi për vendimmarrje të përbashkëta, respektimin e shumëllojshmërisë dhe përdorimin e burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

Shkolla si qendër komunitare synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi, ta bëjë shkollën një mjedis që i shërben komunitetit, por edhe komunitetin si një partner të rëndësishëm që e mbështet shkollën.

SHQK dallon për fokusin e saj në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbështetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare.

SHQK është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në:

- mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve,
- përmirësimin e arritjeve të tyre,
- mbështetjen e familjeve dhe,
- zhvillimin e komuniteteve.

Fillimisht, nisma u pilotua në 66 shkolla, ndërsa në vitin 2015 numri i shkollave si qendra komunitare është 184, ndërsa pritet që deri në vitin 2017 numri i shkollave të përfshira në këtë nismë të arrijë në 350.

### 3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

#### Qëllimi dhe pyetjet kërkimore

Ky vlerësim është realizuar duke mbajtur parasysh tre qëllime: 1) të prezantojë një tablo të ecurisë së nismës; 2) të identifikojë arritjet e deritanishme, sfidat dhe vështirësitë për zbatimin e saj; 3) të formulojë rekomandime për politikëbërësit me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kësaj nisme.

Më specifikisht pyetjet rreth të cilave është kryer vlerësimi janë:

- Sa dhe si është kuptuar nisma nga mësuesit, drejtuesit e shkollave, koordinatorët e SHQK në DAR/ZA, nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit dhe sa janë ndërgjegjësuar ata për këtë nismë?
- Si i kanë përmbushur shkollat standardet e SHQK?
- Cilat janë disa nga arritjet e deritanishme, sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e kësaj nisme?
- A e mbështet SHQK arsimin gjithëpërfshirës dhe nxënësit më vulnerabël?
- Cilat janë rekomandimet që mund t'i jepen politikëbërësve për ta përmirësuar këtë nismë?

#### Metodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave

Për të adresuar pyetjet e lartë përmenduar është realizuar një kombinim e metodave të kërkimit primar me ato të kërkimit sekondar.

*Metodat e kërkimit primar:* Metodave të cilësore të kërkimit janë përdorur për të mbledhur informacion të thelluar dhe të detajuar mbi statusin aktual të zbatimit të SHQK. Më specifikisht metodat e përdorura janë:

- Fokus grup me aktorë të ndryshëm (shiko Aneksin A për guidën e fokus grupeve):
  - Me mësues dhe përfaqësues të bordeve të shkollave (në total 11 fokus grupe, ose 95 mësues);
  - Me prindër dhe anëtarë kyc të komunitetit (në total 6 fokus grupe ose 52 prindër);
  - Më nxënës dhe përfaqësues të qeverisë së nxënësve (në total 10 fokus grupe, ose 90 nxënës).
- Intervista gjysëm të strukturuar me persona kyc (shiko Aneksin B për guidën e intervistës)
  - Mësues kyc/koordinator SHQK/ drejtorë shkollash (13 intervista);
  - Nxënës (9 intervista);
  - Politikëbërës dhe koordinator SHQK në DAR/ZA (11 intervista).

• Gjithashtu janë realizuar një sërë vëzhgimesh të strukturuar në disa prej shkollave të vizituara.

*Metodat sekondare:* janë përdorur për të kuptuar më mirë kuadrin ligjor, institucional të nismës, kontributet e deritanishme nga aktorë të ndryshëm si edhe për të identifikuar praktikat pozitive, mësimet e nxjerra nga zbatimimi i nismave të ngjashme në vendet e tjera të botës. Më konkretisht, një pjesë e dokumentave të shqyrtuara janë:

- Raporte ekzistuese mbi zbatimin e deritanishëm të nismës nga DAR/ZA, IZHA, MAS dhe institucione të tjera;
- Standardet e SHQK të hartuara nga IZHA dhe miratuar nga MAS;
- Strategjia e arsimit para universitar 2014-2020;
- Praktika, modele pozitive dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i SHQK në vende të tjera.

### **Kampioni i vlerësimit**

Popullata nga e cila u përzgjedh kampioni i vlerësimit ishin shkollat SHQK në këto nëntë rajone të vendit: Tropojë, Shkodër, Dibër, Vlorë, Përmet, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë.

*Përzgjedhja e shkollave:* Specialistë të IZHA dhe të DAR/ZA janë konsultuar me qëllim marrjen e një liste të plotë të shkollave SHQK në këto nëntë rajone. Nga kjo listë janë zgjedhur në mënyrë rastësore 3-4 shkolla sipas kriterëve rurale/urbane, 9-vjecare/e mesme si edhe bazuar në nivelin e deritanishëm të performcës së tyre kuadër të SHQK<sup>1</sup> - me qëllim pasjen e një kampioni divers që do të ndihmonte në të kuptuarin jo vetëm të arritjeve, por edhe të vështirësive dhe sfidave.

Në total, 33 shkolla ishin pjesë e këtij vlerësimi. Shiko Ankesin C, për listën e detajuar të shkollave të vizituara dhe të intervistuar për qëllime të këtij vlerësimi.

- 95 mësues që përfaqësojnë 9 rajone gjeografike të vendit janë intervistuar nëpërmjet fokus grupeve. Mësuesit janë përzgjedhur në mënyrë rastësore.
- 13 mësues koordinator SHQK dhe drejtorë shkolle janë intervistuar nëpërmjet intervistës gjysëm të strukturuar.
- 90 nxënës që përfaqësonin 9 rajone gjeografike të vendit janë intervistuar nëpërmjet fokus grupeve.
- 9 nxënës kyc (aktivë në kuadër të SHQK) janë intervistuar nëpërmjet intervistave gjysëm të strukturuar.
- 52 prindër të përzgjedhur në mënyrë rastësore kanë marrë pjesë në fokus grupet e realizuara në pesë rajone: Vlora, Tiranë, Korçë, Shkodër and Elbasan.
- 11 përfaqësues të nivelit qendror dhe lokal (DAR/ZA, MAS, IZHA) janë intervistuar nëpërmjet intervistave gjysëm të strukturuar.

---

<sup>1</sup> Shkolla kanë performancë të ndryshme përsa i përket SHQK. Disa kanë një performancë që mund të konsiderohet në nivele të kënaqshme/të mira/apo disi. Ky lloj vlerësimi bazohet në evidencat anekdotike të marra nga DAR/ZA bazuar në monitorimet e tyre mbi mbarëvajtjen e deritanishme. Gjithësesi, vlen për tu përmendur fakti se deri më tani, nuk është ndërmarrë asnjë vlerësim i mirëfilltë që përcakton në mënyrë objektive nivelin performancës në këtë aspekt.

## **Mbledhja e të dhënave**

Mbledhja e të dhënave u realizua gjatë muajit shtator 2015 nga një ekip profesionistësh të trajnuar në metodat e kërkimit cilësor.

## **Analiza e të dhënave**

Për të rritur objektivitetin e gjetjeve të vlerësimit është bërë një kombinim i metodave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave cilësore (fokus grupe, intervista, vëzhgime, shqyrtim literature) si edhe është mbledhur informacion për të njëjtat çështje nga burime të ndryshme (mësues, prindër, nxënës, drejtues shkolle, koordinator në DAR/ZA, politikëbërës). Prespektivat e aktorëve të ndryshëm janë ballafaquar dhe analizuar në këto aspekte kryesore:

- Ndërgjegjësimi dhe kuptimi mbi iniciativën;
- Mënyra se si standardet janë zbatuar në shkollat/komunitetet përkatëse;
- Arritjet, sfidat/vështirësitë kryesore; Pritshmëritë mbi rolet e aktorëve të ndryshëm;
- Përfshirja e grupeve vulnerabël;
- Sugjerime/rekomandime mbi mënyrën se si mund të adresohen sfidat/vështirësitë me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të iniciativës

Vlen për t'u theksuar fakti se ky vlerësim i procesit i realizuar nëpërmjet metodave cilësore të kërkimit shkencor ka patur në fokus të vet eksplorimin e fenomenit në thellësi, në detaje duke synuar të paraqesi shumëllojshmërinë e çështjeve të raportuara nga prespektiva e aktorëve të ndryshëm.

## **Konsiderata etike**

*Pjesëmarrja vullnetare:* Pjesëmarrësit u informuan paraprakisht dhe pjesëmarrja e tyre në fokus grupe apo intervista ka qenë vullnetare.

*Marrja e miratimit:* Në fillim të fokus grupeve dhe intervistave, pjesëmarrësit u informuan verbalisht në lidhje me qëllimin e vlerësimit dhe miratimi i tyre është marrë para se procesi të fillonte.

*Konfidencialiteti i informacionit:* I gjithë informacioni i mbledhur ngelet anonim dhe konfidencial – pasi qëllimi i këtij vlerësimi nuk është se çfarë thotë një mësues specific në një shkollë të caktuar, por mendimet dhe opinionet e shumë mësuesve të shkollave të ndryshme të cilat duke u analizuar së bashku kanë kontribuar në kuptimin më të mirë të zhvillimeve aktuale në kuadër të SHQK dhe mënyrat se si kjo nisëm të çohet përpara.

Gjetjet e mëposhtme janë renditur sipas çështjeve. Bazuar në vlerësimin e bërë çështjet e identifikuar janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën, ndërkohë që renditja e tyre jo domosdoshmërisht tregon dhe rëndësinë e tyre. Disa prej çështjeve reflektojnë drejtpërdrejt perspektivën e të gjitha grupeve të përfshira në vlerësim (nxënës, mësues, prindër, drejtues dhe koordinatorë) ndërkohë që disa të tjera janë specifike vetëm për disa grupe.

## 4. KONCEPTIMI I PROJEKTIT “SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE”

### 4.1 Baza teorike

Baza teorike që mbështet nismën Shkolla si qendër komutare paraqitet në dy dokumente kryesore që janë “Udhëzues për shkollat qendra komunitare, tetor 2014” dhe “Standardet e shkollës si qendër komunitare”, miratuar nga MAS më 13.03.2014.

Sipas këtyre dokumenteve teorike, koncepti i shkollës si qendër komunitare, mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh të gjithë aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

Shkolla si qendër komunitare është parë si një qasje e rëndësishme e reformimit të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Ajo krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës në lidhje me bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet dhe mbi këtë bazë, hartimin e strategjive që mbështesin ngritjen e një modeli të shkollës komunitare, përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët.

Përfitimet që ofrojnë shkollat komunitare janë të shumta dhe të shumëfishta. Ato sigurojnë, gjithëpërfshirje pa dallime gjinore e të natyrave të tjera, arritje më të mira të fëmijëve dhe të rinjve, garanci për një shëndet më të fortë, pjesëmarrje aktive në vendimmarrje të nxënësve, përfshirje dhe kontribut të gjerë të familjes, hapje ndaj komunitetit dhe strukturave vendore dhe mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë.

*Veçoritë e shkollës si qendër komunitare paraqiten si më poshtë:*

- SHQK konsiderohen ato institucione arsimore, të cilat i shërbejnë jo vetëm komunitetit shkollor (nxënës dhe mësues) por janë të hapura dhe në shërbim të gjithë anëtarëve të komunitetit.
- SHQK janë institucione të cilat ngrenë dhe zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit;
- SHQK ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, për nxënësit, familjet dhe komunitetin;
- SHQK pranojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta;
- SHQK sigurojnë kohezionin social;
- SHQK ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit.

Në kuadrin e SHQK, shkollat, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet;
- për të pasuruar dhe nxitur formimin e nxënësve përmes veprimtarive formale dhe jo formale;

- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.

*Parimet bazë që udhëbeqin shkollën si qendër komunitare janë:*

- Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo nxënës.
- Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve.
- Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit.
- Vendimmarrja e përbashkët.
- Respektimi i diversitetit.
- Përdorimi i burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

*Veprimtaritë e parashikuara të shkollës si qendër komunitare grupohen në katër lloje:*

#### *1. Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve*

Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor.

Ka disa rrugë për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve:

- Veprimtari për përforsim të të nxënësve. Këto veprimtari bëhen për të zotëruar më mirë aftësitë që nxënësi po mëson në klasën e tij siç janë konsultimet lidhur me lëndët.
- Veprimtari për pasurimin e zhvillimit akademik. Këto kurse/klube ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare apo dhe fushave të tjera kurrikulare.

Shkolla ndërton kurse akademike të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësve në orën e mësimor.

Shkolla ngre klube në mbështetje të thellimit dhe plotësimit të njohurive të tij në fusha të ndryshme apo të zhvillimit të të menduarit kritik.

*2. Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv* – Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.

*3. Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes* – Shkolla si qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burim të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve.

Këto mund të jenë veprimtari që:

- ndihmojnë prindërit të ndjekin përparimin e fëmijës. Shkolla është tërësisht transparente para prindërve;
- ndihmojnë prindërit të mbështesin fëmijët e tyre dhe shkollën si institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në shkollë;
- plotësojnë nevojat e prindërve.

4. *Veprimtari për angazhimin e komunitetit* – Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënëit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

Për të orientuar veprimtarinë e SHQK dhe për të vlerësuar efektshmërinë e saj një grup pune i përbërë nga specialistë të MAS, IZHA, Unicef dhe World Vision përgatitën “*Standardet e shkollës si qendër komunitare*”

Për më shumë se një dekadë e gjysëm aktorë të ndryshëm të arsimit kanë zhvilluar dhe zbatuar qasje të ndryshme në shkolla që kanë synuar formësimin e një shkolle më miqësore për fëmijët, më gjithëpërfshirëse dhe më miqësore për komunitetin, megjithatë ato kanë mbetur të fragmentarizuara.

Në këtë kuadër, standardet e SHQK janë pika referimi për organizimin e veprimtarive të nismës dhe për vlerësimin e përmbushjes së synimeve dhe objektivave të saj. Standardet e shkollës si qendër komunitare janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj si vendi ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi, të shprehura nëpërmjet treguesve përkatës, për të cilat është siguruar një miratim dhe rënie dakord në shkallë të gjerë nga komuniteti edukativ dhe nga institucionet shtetërore.

Standardet paraqiten të ndara në disa grupime (fusha) dhe shprehen nëpërmjet treguesve të detajuar, që, nga ana e tyre, provojnë përmbushjen e standardeve nga shkolla. Standardet e paraqitura janë standarde bazë, në kuptimin që ato duhet t’i përmbushë secila shkollë për t’u quajtur si shkollë komunitare.

*Pse nevojiten standardet e shkollës si qendër komunitare*

- Standardet përshkruajnë karakteristikat themelore të një shkolle si qendër komunitare në mënyrën më të përmbledhur dhe më të përdorshme, sesa të gjithë dokumentet e tjera, ndaj krijojnë lehtësi për shkolla dhe menaxhuesit e tyre.

- Standardet përbëjnë një marrëveshje të pranuar nga të gjithë dhe, si të tilla, janë më të besueshme se përshtypjet dhe konsideratat qofshin individuale apo në grup. Gjithashtu, standardet shërbejnë si argumente për shumë programe të zhvillimit që shkojnë në dobi të zhvillimit të shkollës.
- Standardet vijnë si rezultat i kërkimeve dhe i përvojave shumëvjeçare, ndaj dhe janë me më shumë vlera sesa punimet individuale brenda fushës së arsimit.
- Shkolla, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të punës së saj, për të konfirmuar nivelin ku ndodhet dhe përmirësimet që duhet të bëjë.

#### *Fushat e standardeve*

##### *1. Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënësi*

Standardi 1: Përbushja e nevojave dhe interesave të nxënësve

Standardi 2: Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së shkollës

Standardi 3: Cilësia e mësimdhënies

##### *2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve*

Standardi 1: Mbështetja e zhvillimit social, emocional dhe shëndetësor të nxënësve

Standardi 2: Mbrojtja dhe mekanizmat e referimit

Standardi 3: Mjedis fizik i shkollës

##### *3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit*

Standardi 1: Prania e prindërve në shkollë

Standardi 2: Shkolla ofron zhvillim për komunitetin

Standardi 3: Krijimi i kushteve që mundësojnë zhvillim të përbashkët

Treguesit:

Standardi 4: Financimi i kurseve që ofrohen për komunitetin dhe nga komuniteti

Standardi 5: Prindërit janë të përfshirë në planifikimin, menaxhimin, vlerësimin zbatimin dhe aprovimin e programit në oraret jashtë shkollore.

##### *4. Vendimmarrja e përbashkët*

Standardi 1: Planifikimi strategjik i institucionit arsimor

Standardi 2: Drejtimi i institucionit arsimor

Standardi 3: Organizmat e institucionit arsimor

Standardi 4: Zëri i komunitetit në vendimmarrjen e përbashkët

##### *5. Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit*

Standardi 1: Respektimi i të drejtave të fëmijëve

Standardi 2: Mundësi të barabarta për t'u regjistruar në shkollë, për ta ndjekur dhe përfunduar atë.

Standardi 3: Përshtatja me nevojat e zhvillimit të fëmijës

Standardi 4: Mjedisi pa pengesa

Standardi 5: Infrastruktura e disponueshme për personat me aftësi të kufizuar

Standardi 6: Infrastruktura duhet të jetë e disponueshme nga të dy gjinitë

Standardi 6: Qeverisja e shkollës

Standardi 7: Veprimtaritë mësimore

#### **4.2 Baza ligjore dhe politika arsimore**

Legjislacioni shqiptar për arsimin, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, Projektstrategjia e arsimit parauniversitar 2014-2020, udhëzime të MAS dhe dokumente të DAR mbështesin funksionimin e ShQK. Dokumentet e drejtpërdrejta që lidhen me zbatimin e nismës janë si më poshtë vijon:

1. *Urdhër i MAS Nr. 464, datë 01.11.2013 "Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e projektit "shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë"*

Ky urdhër i kushtohet ngritjes së grupit të punës për zbatimin e projektit dhe detyrave të këtij grupi pune.

2. *Standardet e shkollës si qendër komunitare, miratuar nga MAS më 13.03.2014.*

Qëllimi kryesor i hartimit të standardeve të SHQK është të ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në tërë procesin e edukimit të nxënësve nëpërmjet partneritetit shkollë-familje-komunitet. Ky dokument përmban standardet bazë, në kuptimin që ato duhet t'i përmbushë secila shkollë për t'u quajtur si shkollë komunitare. 22 standarde janë grupuar në pesë fusha kryesore. Ky është një dokument i përgatitur nga grupi i punës për zbatimin e nismës.

3. *Letër sqaruese e MAS për funksionimin e shkollës si qendër komunitare, datë 31.03.2014. drejtuar DAR/ZA*

Kjo letër sqaruese përqendrohet në katër fazat e zhvillimit të nismës SHQK:

Faza 1: Konsolidimi i nismës në secilën DAR/ZA dhe shkollë pilot;

Faza 2: Promovimi i nismës së shkollave si qendra komunitare në komunitet

Faza 3: Bashkërendimi i veprimtarive me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe pushtetin vendor.

Faza 4: Bashkërendimi i veprimtarive me aktorë të tjerë në mbështetje të qasjes SHQK

Në këtë dokument jepen udhëzime për organizmat që duhet të ngrihen dhe të veprojnë në nivel lokal dhe institucional dhe detyrat që duhet të përmbushin DAR/ZA dhe shkollat që pilotojnë SHQK.

Dokumenti udhëzon ngritjen e ekipit koordinues në çdo DAR/ZA, ngritjen e rrjetit të SHQK, ngritjen e ekipit koordinues në çdo shkollë.

Në këtë dokument përcaktohen detyrat e DAR/ZA për bashkërendimin e veprimtarive me institucionet e arsimit të lartë, me pushtetin lokal dhe me aktorë të tjerë që angazhohen për të mbështetur nismën SHQK.

Ky dokument përcakton si domosdoshmëri raportimin një herë në javë për ecurinë e SHQK

- nga ekipi koordinues i shkollës të koordinatori përkatës i DAR/ZA;
- nga ekipi koordinues i DAR/ZA në MAS.

#### 4. *Dokumenti i Strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (draft)*

Ky dokument është një nga përbërësit e Planit strategjik të arsimit për priudhën 2014-2020. Ai shpreh vizionin e politikës arsimore për arsimin parauniversitar dhe përcakton përparësitë arsimore kombëtare për një periudhë 6 vjeçare. Në këtë dokument, në kuadrin e Objektivit B “Nxënia gjithëpërfshirëse dhe cilësore” është parashikuar si objektiv politik “Shkolla si qendër komunitare”. Strategjia parashikon që ky objektiv të realizohet nëpërmjet katër grupeve të veprimtarive:

B3.1 Fuqizohet dhe zgjerohet rrjeti i shkollave qendra komunitare

B3.2 Krijohen mjedise shkollore miqësore për fëmijët, pa dhunë, mjedise që ndihmojnë, kujdesen dhe kultivojnë vlerat demokratike dhe ofrojnë modele positive.

B3.3 Garantohet oferta shkollore përmes treguesve të standardizuar

B3.4 Zbatohen plane për digjitalizimin e hartës së shkollave dhe optimizohet rrjeti i shkollave

Në këtë dokument është përfshirë edhe plani i veprimit për realizimin e objektivit që lidhet me SHQK, përgjegjësit për realizimin e veprimtarive si dhe buxheti i parashikuar për tre nga katër grupet e veprimtarive.

#### 5. *Udhëzim i MAS Nr.44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH Nr.21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”*

Ky udhëzim në pikën “Norma të veçanta” përcakton që për zhvillimin e veprimtarive konkrete në kuadër të shkollës si qendër komunitare të llogariten 10 orë në javë.

### 4.3 Baza institucionale

Për të realizuar nismën SHQK kanë marrë përgjegjësi përkatëse Ministria e Arsimit dhe Sportit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe shkollat e përfshira në projekt.

- MAS me *Urdhërin Nr. 464, datë 01.11.2013* ka ngritur grupin qëndror të punës për zbatimin e nismës me përfaqësues të MAS, IZHA, UNICEF, World Vision, të DAR Durrës, Korçë, Berat dhe të shkollës 9-vjeçare “Konferenca e Pezës” Tiranë.
- *Bazuar në Letrën e MAS për funksionimin e shkollës si qendër komunitare, datë 31.03.2014 drejtuar DAR/ZA* e cila sqaron se cilat janë institucionet dhe organizmat përgjegjëse për zbatimin e nismës dhe detyrat e tyre, në nivel lokal dhe institucional janë ngritur dhe veprojnë:
  - koordinatori i SHQK në çdo DAR/ZA;
  - ekipi koordinues i SHQK i cili përbëhet nga drejtori (ose nëndrejtori) i shkollës i cili është dhe drejtues i ekipit, anëtarë të bordit të prindërve, nxënës përfaqësues të qeverisë së nxënësve, mësues të shkollës, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe përfaqësues të partnerëve të tjerë socialë. Ky ekip angazhon përfaqësues të tij ose ngre një ekip të posaçëm, i cili angazhohet në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve.
- Bordi i shkollës është “zëri” i komunitetit në shkollë. Ai luan rol të veçantë në marrjen e vendimeve për angazhimin e shkollës në nismën SHQK.
- Qeveria e nxënësve është një organizëm që vepron në çdo shkollë dhe ka përgjegjësi të caktuara për realizimin e nismës

## 5. GJETJET NGA ZBATIMI I DERITANISHËM I SHQK

Në përgjithësi, nisma SHQK, është mirëpritur pozitivisht në shkollat ku ajo po zbatohet. Në secilën shkollë janë organizuar një sërë aktivitete të cilat kanë krijuar një dinamikë të re pozitive. Kjo dinamikë e re reflektohet nga të gjitha grupet e intervistuar. Ndikimi i aktiviteteve të realizuara si tek mësuesit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti është i ndryshëm në shkollat të ndryshme. Ka një seri aktivitete të konceptuara mirë, të cilat kanë patur një jehonë pozitive tek të gjitha palët. Ideja e SHQK-së jo vetëm ka ndikuar pozitivisht për një ndërveprim më cilësor mes palëve, por dhe ka nxitur ide dhe projekte të mësuesve/nxënësve/ dhe shkollave të ndryshme.

Fillimisht nisma u pilotua në 66 shkollat në shkallë vendi (35 në arsimin 9-vjeçar dhe 31 në arsimin e mesëm dhe atë profesional), ndërsa në vitin 2015 numri i shkollave si qendra komunitare është 184, ndërsa pritet që deri në vitin 2017 numri i shkollave të përfshira në këtë nismë të arrijë në 350.

## 5.1 Kriteret e përzgjedhjes së shkollave

Përzgjedhja e shkollave pilot: 66 shkollat u përzgjedhën mbi bazën e disa kriterëve bazë të cilat u hartuan nga IZHA dhe u shpërndanë në 37 DAR/ZA. Shkolla si qendër komunitare duhet të plotësonin kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë mjedise fizike të vlefshme dhe të sigurta për zhvillimin e veprimtarive pas shkollore.
2. Të ketë hapësira kohore të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve (shkolla të mos punojë me dy turne).
3. Të jetë e aksesueshme nga përqindja më e lartë e komunitetit.
4. Të përdoren shkollat që kanë pasur investime dhe eksperiencë të mëparshme të mbështetura nga donatorë dhe MAS.
5. Staf i shkollës të jetë i kualifikuar, të ketë rezultate të larta në provime të kualifikimit, të kenë ndjekur trajnime të organizuara nga Institucionet Arsimore.
6. Të ofrojë mbështetje për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë.
7. Organizmat brenda shkollës (bordi shkollor, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve) të jenë funksionale.
8. Të demonstrojë aftësi të larta menaxheriale, dhe aftësi në mënyrat e menaxhimit të projekteve.
9. Të ketë një psikolog dhe tregues të bashkëpunimit me Njësinë e Mbrojtjes së fëmijëve.
10. Drejtuesit e shkollës të kenë aftësi menaxheriale, komunikuese, koordinuese, dixhitale.

Kriteret e lartpërmendura kanë qenë të vlefshme edhe për përfshirjen e shkollave të reja që u bënë pjesë e nismës – megjithatë, në përfshirjen e shkollave të reja nuk janë marrë parasysh të gjitha kriteret (p.sh. përpos dëshirës së mirë, disa shkolla me dy turne janë pjesë e nismës) duke e bërë kështu disi më të vështirë zbatimin e nismës në praktikë.

Gjithësesi, ky aspekt është adresuar nga MAS duke ftuar të gjitha DAR/ZA për të bërë një rivlerësim të hartës shkollore (deri në 14 nëntor 2015) dhe për të rikonsideruar përfshirjen ose jo të shkollave si pjesë e SHQK në nivel DAR/ZA marrë parasysh kriteret e lartpërmendura.

## 5.2 Mbështetje teknike për nismën

**Trajnime dhe materiale udhëzuese:** Nisma është mbështetur nga një sërë trajnimesh dhe materialesh me karakter udhëzues dhe orientues të hartuara të tilla si:

- *Hartimi i "Udhëzuesit për Shkollat Qendra Komunitare" nga IZHA dhe mbështetur nga SAVE the Children në tetor 2014.*

Ky udhëzues synon t'u vijë në ndihmë mësuesve dhe drejtuesve të shkollave. Në këtë udhëzues paraqiten hapat që duhet të ndërmerren për planifikimin e veprimtarive për SHQK si dhe elementet kryesorë që përmban plani i veprimtarive. Ofrohen ide dhe modele alternative që i japin mundësi drejtuesve dhe mësuesve t'i shfrytëzojnë dhe pasurojnë ato më tej sipas specifikave të secilës shkollë. Udhëzuesi ofron ide dhe orientime sesi aktorët e ndryshëm të komunitetit mund të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në veprimtaritë e shkollës, shoqëruar kjo edhe me modele instrumentesh për vlerësimin e nevojave dhe burimeve si edhe me modele materialesh konkrete të formimit të partneritetit shkollë-familje. Në Udhëzues përcillet dukshëm ideja se SHQK është një projekt i përbashkët që dallon për tërësinë e marrëdhënieve që lidhin shkollën, familjen dhe komunitetin. Veprimtaritë në shkollë realizohen si bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës dhe fokusohen në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve, përmirësimin e arritjeve të tyre, mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e komuniteteve.

- *Hartimi i moduleve të trajnimit për Shkollën si Qendër Komunitare nga IZHA dhe mbështetur nga Save the Children në mars 2015.*

Ky modul trajnimi ka tre pjesë kryesore (të planifikuara të realizohen në 3 ditë të ndryshme) dhe synon t'i vijë në ndihmë mësuesve, nxënësve, koordinatorëve të SHQK në shkollë dhe DAR/ZA. Çështjet kryesore që janë adresuar në këtë modul trajnimi janë:

- Planifikimi në shkollën qendër komunitare;
  - Roli i bordit të shkollës dhe i komunitetit në shndërrimin e shkollës në qendër komunitare;
  - Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrjen e përbashkët në SHQK.
- Organizimi i një cikli trajnimi 3-ditor nga IZHA dhe DAPU gjatë periudhës prill-maj 2015. Përfituesit e këtyre trajnimeve ishin: koordinatorë të SHQK në nivel qarku dhe rrethi; koordinatorë të SHQK në nivel shkolle; drejtues shkollash dhe mësues; përfaqësues të organizmave të shkollës (prindër, nxënës, përfaqësues të tjerë të komunitetit). Tematikat e adresuara gjatë këtij cikli trajnimi ishin:
    - Koncepti i SHQK. Llojet e veprimtarive të SHQK;
    - Planifikimi i veprimtarive të SHQK. Formatet e planifikimit.
    - Bashkëpunimi dhe angazhimi i aktorëve partnerë të SHQK.

***Mbështetja e iniciativës nga donatorë/partnerë të ndryshëm:*** Në mbështetje të zbatimit të nismës SHQK janë organizuar nga MAS dy takime me donatorë, përkatësisht në 25 nëntor 2013 dhe 17 shkurt 2014. Institucione dhe organizata partnere të MAS të tilla si: Këshilli i Europës, Unicef,

Korpusi i Paqes, World Vision, Save the Children, Terre Des Hommes, Këshilli Britanik, Sorros, Cospe etj., janë angazhuar për të mbështetur disa shkolla pjesë të kësaj nisme.

Në bashkëpunim me partnerët si “Save the Children”, “Unicef”, “World Vision”, dhe donatorë të tjerë nga sektori privat u organizua “Panairi i ideve të shkollave si qendër komunitare” në Qershor 2015, ku u përfshinë 45 shkollave nga të gjitha qarqet e vendit dhe ku u prezantuan projekt-identë e nxënësve.

**Portali online:** Pritet që së shpejti MAS të promovojë dhe të vërë në funksionim Portalin online të “Shkollës si Qendër Komunitare”, portal i hartuar nga MAS, IZHA në bashkëpunim me World Vision. Qëllimi i këtij portali është t’i vijë në ndihmë komunitetit të shkollës në kryerjen e vetëvlerësimit të standardeve dhe treguesve të ShQK-së, krijimin e planeve të punës dhe menaxhimin e aktiviteteve që kontribuojnë në 5 fushat e modelit të ShQK. Kjo lloj qasje që orienton shkollat të vetvlersojnë nevojat e tyre duke i krahasuar me treguesit e standarteve synon të nxitë mobilizimin e komunitetit të shkollës, prindërve, bizneseve në zona, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që të angazhohen në nisma të përbashketa informuese, ndërgjegjësuere dhe advokuese që sigurojnë cilësinë e arsimit nëpërmjet zbatueshmërisë konkrete të treguesve dhe standarteve të ShQK. Ky portal do të jetë i aksesueshëm nga të gjitha shkollat ShQK në Shqipëri.

### **5.3 Terminologjia që lidhet me SHQK:**

Në dokumentacionin zyrtar për SHQK janë përdorur disa përcaktime, si: qasje, lëvizje, nismë, projekt.

Në dokumentin *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (draft)* përdoren fjalët “nismë, projekt”

“Për përmirësimin e cilësisë së punës dhe të jetës në shkollat e vendit, MAS-i ka ndër marrë *nismën* “Shkolla si Qendër Komunitare - Një shkollë miqësore për të gjithë”. (faqe 45)

*Projekti i shkollës si qendër komunitare* do të mundësojë sigurimin e një arsimit cilësor për çdo nxënës, në mjedise që mundësojnë kultivimin e vlerave demokratike, sigurimin e mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve, angazhimin dhe zhvillimin e komunitetit, vendimmarrje të përbashkëta, respektimin e shumëllojshmërisë dhe përdorimin e burimeve komunitare në shërbim të shkollës.” (faqe 45)

Në dokumentin *“Standardet e shkollës si qendër komunitare, miratuar nga MAS më 13.03.2014 janë përdorur termat qasje, lëvizje, nismë si më poshtë:*

*“Shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë është një qasje (lëvizje promovuese dhe zhvilluese) për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.” (faqe 3)*

*“Shkolla qendër komunitare (SHQK) është një nismë e përbashkët që dallon për tërësinë e marrëdhënieve që lidhin shkollën, familjen dhe komunitetin.” (faqe 3)*

Në dokumentin *“Urdhër MAS Nr. 464, datë 01.11.2013 “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e projektit “shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë” flitet për zbatimin e projektit shkolla qendër komunitare.*

Në dokumentin *“Letër sqaruese për funksionimin e shkollës si qendër komunitare, datë 31.03.2014. drejtuar DAR/ZA” përdoren fjalë nismë dhe qasje.*

Konsolidimi i nismës në secilën DAR/ZA (faqe 1).

*“Pse shkolla është pjesë e qasjes “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”; “Kush e drejton këtë qasje në shkollë”;(faqe 2).*

Do të ishte e dëshirueshme që të unifikohet terminologjia për këtë ndërmarrje në mënyrë që të gjitha institucionet dhe aktorët të përdorin të njëjtën gjuhë dhe të nënkuptojnë të njëjtën përmbajtje konceptuale.

#### **5.4 Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i konceptit të shkollës si qendër komunitare**

Koncepti i shkollës si qendër komunitare artikulohet në mënyra të ndryshme nga mësues, drejtues, nxënës apo prindër të përfshirë në fokus grupe dhe intervista individuale për qëllime të këtij vlerësimi. Nisma “Shkolla si qendër komunitare” konceptohet në tërësi si një bashkëpunim ndërmjet shkollës dhe komunitetit:

*“SHQK ka të bëjë me përfshirjen e komunitetit në proceset e edukimit në shkollë dhe shkolla në rol më aktiv në problemet që shqetësojnë komunitetin. Si pasojë mundësohet rritja e cilësisë së edukimit sepse rritet dhe dimension i llogaridhënës dhe i ndjeshmërisë për problemet e komunitetit. Kjo nismë ka si synim të realizojë aktivitete jashtë shkolle, që t’u vinë në ndihmë njerëzve që kanë nevojë.” (Fokus grup me nxënës)*

*“Shkollat komunitare janë ato shkolla 9-vjeçare, por dhe ato të mesme që kanë një bashkëpunim midis mësuesve, prindërve dhe nxënësve. Po ashtu të trija këto palë marrin pjesë në identifikimin dhe realizimin e*

*aktiviteteve që kryen shkolla. Shkolla sipas kësaj nisme qëndron e hapur pas orës dy. Sipas kësaj nisme shkolla ofron kurse, trajnime për komunitetin sipas nevojave.” (Fokus grup me prindër)*

*“Shkolla si qendër komunitare përbën angazhimin për t’a shkëputur shkollën nga aspekti formal i saj. Ikja nga formalizmi nënkupton hapjen e shkollës ndaj grupimeve të tjera shoqërore dhe një formë të re bashkëpunimi me komunitetin specifikisht me prindërit. SHQK ofron transparencë për komunitetin dhe kërkon forma të tjera bashkëpunimi me grupe të ndryshme komunitare dhe shkollës.” (Fokus grup me mësues)*

*“Thelbi i kësaj strukture është që komuniteti të jetë sa më pranë shkollës. Duhet të jetë një aktivitet social, moral, por edhe vullnetar që komuniteti të jetë pranë shkollës dhe ta ndiejë shkollën pjesë të saj.” (Fokus grup me mësues)*

Pavarësisht artikulimit teorik thuajse në të gjitha shkollat, në realizimin praktik duket se ka një kuptim të cekët apo tepër simplist dhe mekanik të shkollës si qendër komunitare në një pjesë të mirë të tyre.

Standardet e shkollës si qendër komunitare (fushat dhe treguesit) nuk shihen të ndërlidhura dhe ndërvarura mes tyre. Aktivitetet, përgjithësisht, janë të fokusuar në fusha dhe tregues specifikë duke rezultuar si një përmbushje apo zbatim mekanik i tyre.

Në këto raste kjo nismë edhe pse e artikuluar teorikisht, konceptohet dhe reduktohet: në një tërësi aktivitetesh jashtëshkollore që pjesën më të madhe të rasteve ideohen dhe planifikohen nga mësuesit, nga disa nxënës aktivë të shkollës dhe më pak ose aspak nga prindër apo anëtarë komuniteti.

*“Mund të zhvillojmë një larmi tematikash, të merret seriozisht dhe të zbatohet nga të gjithë aktorët e mundshëm. Të bëhet seriozisht gjithçka në mënyrë që komuniteti ta ndiejë, jo për hir të orëve dhe detyrimeve.” (Fokus grup, mësues)*

Në disa raste mësuesit dhe drejtuesit e perceptojnë si një nismë të marrë nga “lart” e cila bën që ata të angazhohen thjesht për ta zbatuar atë, pa u thelluar shumë në logjikën dhe filozofinë e nismës.

Në disa raste të tjera ka paqartësi dhe vështirësi për të bërë dallimin ndërmjet aktiviteteve normale të shkollës dhe aktiviteteve në kuadër të SHQK-së (siç mund të jetë për shembull, organizimi i aktiviteteve në kuadër të festave të Nëntorit, festës së fëmijëve apo festave të fundvitit).

Po ashtu, edhe pse në pak shkolla, ekziston një perceptim tek disa drejtues dhe mësues se ka mbivendosje të standardeve të SHQK-së dhe misionit të vetë shkollës.

*“Kur flasim për iniciativë, unë them që ajo duhet të nisët nga baza dhe më pas të ngjitet lart. Neve kjo gjë na vjen nga lart, pra na vjen më shumë si detyrim, sesa si diçka e jona.” (Fokus grup, mësues)*

*“Është e rëndësishme që të bëhen sa më shumë trajnime për të sqaruar konceptin e shkollës komunitare. Le të marrim konceptin e mirëqënies fizike, emocionale dhe sociale. Shkollat sot përgjithësisht kanë shërbimin psikosocial dhe e kanë manualin se çfarë duhet të bëjnë. Pra, këtu kemi mbivendosje.” (Drejtues, shkollë 9-vjeçare)*

*“Në konceptin tim, unë e vë në dyshim standardin e edukimit cilësor të shkollës komunitare. Ky është objektiv thelbësor i vetë procesit normal të mësimt”. (Drejtues, gjimnazj).*

Nisma SHQK nuk është perceptuar si një proces shndërrimi gradual i shrirë në kohë i veprimtarisë dhe qëndrimeve të shkollës dhe aktorëve të saj, por si një tërësi veprimtarish që zhvillohen përgjatë një viti shkollor. Është e rëndësishme që të gjithë aktorët ta perceptojnë nismën si proces zhvillimesh dhe ndryshimesh që kanë nevojë për kohën e vet dhe për një larmi veprimtarish.

## **5.5 Zbatimi në praktikë i standardeve të SHQK**

### **5.5.1 Statusi aktual i zbatimit në praktikë të standardeve të SHQK**

Deri më tani duket se ka një preokupim serioz nga ana e aktorëve kryesorë të shkollës (drejtues, koordinatorë, psikologë, mësues, nxënës) për të realizuar aktivitete në kuadër të zbatimit të SHQK.

Ajo që u vu re nga vëzhgimet, fokus grupet dhe intervistat ishte se shkollat ishin përqendruar kryesisht në realizimin e aktiviteteve që lidhen kryesisht me këto fusha kryesore të standardeve për SHQK:

*Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës.* Pavarësisht se janë realizuar trajnime sqaruese se cili është qëllimi i mirëfilltë i kësaj fushe, pjesa më e madhe e shkollave e kanë perceptuar këtë fushë më tepër si organizimin e kurseve të avancuara sipas lëndëve për të cilat nxënësit shfaqin më shumë interes (të tilla si anglisht, fizikë, kimi, biologji, matematikë), apo kurseve parapërgatitore për maturantët dhe nxënësit e klasave të 9-ta.

*Sigurimi i mirëqënies sociale, emocionale dhe shëndetësore të nxënësve.* Shkollat janë përqendruar më tepër në organizimin e aktiviteteve argëtuese, kulturore, sportive të tilla, si: kampionate basketbolli, futboli, volejboli, kërcime, klubi i pikturës, dramës, gazeta e shkollëse etj., si edhe në realizimin e grupeve të diskutimit për tematika të ndryshme që mund të shqetësojnë nxënësit në raport me moshën.

*Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit.* Duket se kjo fushë e SHQK është kuptuar mirë nga mësuesit dhe nxënësit. Ja se si shprehet një nxënës: “*Qëllimi i këtyre aktiviteteve është bashkimi i të gjitha komuniteteve që të ndihen si një grup i vetëm, ku punojnë të gjithë së bashku duke respektuar diferencat*”. Jo vetëm është kuptuar, por vihen re përpjekje serioze nga ana e shkollës për të adresuar nevojat e grupeve vulnerabël, kjo më e evidente në ato shkolla që janë në zona ku komuniteti është heterogjen dhe me nevoja të mëdha socio-ekonomike.

Fushat që janë adresuar më pak nga shkollat:

*Angazhimi dhe mbështetja e familjes dhe komunitetit.* Përsa i kërket kësaj fushe duket se shkollat janë duke u përpjekur në këtë drejtim, pavarësisht vështirësive që hasin. Ka një tendencë drejt përfshirjes së prindërve për të mbështetur shkollën dhe më pak drejt shkollës që mbështet prindërit/komunitetin. Në rastet më të mira, por që kanë qënë të kufizuara në numër, aktivitetet në këtë kuadër duket se janë fokusuar kryesisht në: shpërndarjen e pyetësorëve për të vlerësuar nevojat e prindërve; në pak shkolla janë ftuar prindër të profesioneve të ndryshme të realizojnë një tematikë diskutimi; prindër që kanë kontribuar financiarisht apo materialisht për aktivitete të ndryshme; si edhe pjesëmarrje e thjeshtë e prindërve në aktivitetet që realizon shkolla. Në pak shkolla ka patur aktivitete me vlerë në ndihmë të komunitetit si për shembull: nxënësit kanë lyer pemët apo kanë pastruar mjedisin etj.

*Vendimarrja e përbashkët.* Ky aspekt duket se njihet dhe pranohet mirë në teori se- *prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimarrjet e shkollës* por, realizohet vetëm formalisht në praktikë duke u mjaftuar me ekzistencën formale të strukturave brenda shkollës si Qeveria e nxënësve, Këshilli i prindërve apo Bordi i shkollës. Nga fokus grupet dhe intervistat rezultoi se në pjesën më të madhe të shkollave Bordi i shkollës mblidhet për të miratuar formalisht planin vjetor, Këshilli i prindërve mblidhet kryesisht vetëm me nxitjen apo kërkesën e mësuesve dhe Qeveria e nxënësve është më aktive se dy strukturat e para. Bordi i shkollës dhe Këshilli i prindërve janë angazhuar më pak në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK, ndërsa Qeveria e nxënësve paraqitet më tepër aktive në këtë drejtim. Pavarësisht se Qeveria e nxënësve së bashku me mësuesin koordinator të SHQK angazhohen seriozisht në pjesën më të madhe të shkollave, ngelet shumë për t’u bërë në lidhje me pozicionimin e tyre si “urë lidhëse” midis shkollës dhe aktorëve të saj – familjes – komunitetit.

### 5.5.2 Statusi aktual i angazhimit të aktorëve të ndryshëm në iniciativë

Përsa i përket nivelit të angazhimit, nga fokus grupet dhe intervistat me nxënës, prindër, mësues, drejtues dhe koordinatorë vërehet se mësuesit janë aktorët kryesorë, apo “motori” i kësaj iniciative, më pas vijnë nxënësit dhe më pas prindërit.

*“Për mendimin tim mësuesit janë të parët, pastaj nxënësit dhe në fund komuniteti. Nuk di të të them nëse e kanë nga pasioni apo e kanë për detyrë, por ata janë më të angazhuarit.” (Fokus grup me nxënës gjimnaz)*

*“Zysbat i kemi patur gjithmonë në krabë, ato kanë qenë shtysa e parë për të gjitha llojet e aktiviteteve. Janë shumë korrekte dhe përpiqen shumë.” (Fokus grup me nxënës 9-vjecare)*

## 5.6 Procesi i transformimit të shkollës si një qendër komunitare e vërtetë

Transformimi i shkollës në një shkollë qendër komunitare është një proces i cili ka nisur që prej vitit 2013. Përgjatë këtij procesi, përpos vullnetit dhe dëshirës së mire, aktorët kryesorë përgjegjës për zbatimin e kësaj nisme kanë hasur vështirësi dhe problematika të natyrave të ndryshme. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur problematikat kryesore që kanë dalë gjatë vëzhgimeve, fokus grupeve dhe intervistave të realizuara.

### 5.6.1 Infrastruktura

Për realizimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të SHQK, shkollat shpesh janë edhe të kushtëzuara nga infrastruktura ekzistuese. Mungesa e laboratorëve, internetit, palestrave, bazës materiale, ngrohjes ndikojnë drejtpërdrejtë në llojin dhe cilësinë e aktiviteteve që përzgjidhen për t’u realizuar nga mësuesit, nxënësit dhe komuniteti. Në një prej shkolla të intervistuar mësimi zhvillohej me dy turne dhe kjo bëhej pengesë për realizimin e aktiviteteve. Mungesa e infrastrukturës bazë është artikuluar në të gjitha fokus grupet e realizuara me mësues, nxënës, drejtues dhe prindër.

*“Unë kam 13 vjet mësues i edukimit fizik dhe nuk kam marrë asnjëherë bazë materiale.” (Mësues gjimnazi)*

*“Ne nuk kemi oborr, por për palestër as që bëhet fjalë. Kemi një shkollë me klasa dhe vetëm kaq. Çfarë*

*aktivitetesh mund të bësh në këto kushte?” (Mësues, shkollë 9-vjeçare)*

*“Laboratori i informatikës është pothuaj bosh, nuk ka internet, nuk ka fotokopje, nuk kemi letër. Pra një orë informatike është e pamundur të realizohet.” (Mësues, shkollë e mesme)*

*“Kushtet janë të këqija, as komuniteti dhe as shteti nuk kanë vënë dorë. Palestra pikon, nuk ka ngrohje, dritaret qëndrojnë hapur, tualetet janë në gjendje shumë të keqe. Prindërit duan kushte që të pranojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete.” (Fokus grup, prindër).*

### 5.6.2 Pretendimi për mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve

Sipas mësuesve dhe koordinatorëve, me qëllim realizimin cilësor të një aktiviteti në kuadër të SHQK gjithmonë ka kosto financiare. Në këto kosto mund të përfshihen uniforma për nxënësit, materiale sportive, qendër zëri, letër, fotokopje, bazë materiale për gatim etj. Këto kosto janë të papërballueshme nga buxheti i shkollës (fondi vjetor i mbledhur nga prindërit) dhe nga ana tjetër është e pamundur të kërkohet mbështetje financiare nga prindërit marrë parasysh nivelin e varfërisë dhe papunësisë.

*“Sot po diskutohej në klasën tonë për të bërë një dramatisim dhe kjo gjë do kostumografinë, veshjet dhe shumë inskenime të ndryshme të cilat patjetër kanë një kosto dhe këtë duhet ta japin familjet tona.” (Nxënësi, shkollë e mesme)*

*“Nëse do të kishte bazë materiale do të ishte shumë më mirë. Kur nxënësit shikojnë që aktivitetet kanë kosto dhe këtë kosto pritet që ta mbulojnë familjet e tyre tërbiqen nga aktivitetet.” (Nxënësi, shkollë 9-vjeçare)*

*“Disa gjëra të tjera janë të vështira për t’u realizuar si pasojë e mbështetjes së pakët që kemi, pasi nuk kemi fonde. Për shembull, ne e kemi të vështirë të bëjmë aktivitete sepse nuk kemi qendër zëri. Nga 300 nxënës që ka shkolla, mbledhen rreth 20.000 lekë të reja, sepse rreth 85 familje që kanë nxënësit në shkollë janë me përkrahje sociale. Këto familje nuk mund të japin asnjë kontribut financiar.” (mësues, gjimnaz)*

*“Po ja, për shembull, këto që kanë aktivitete lidhur me gatimin. Ti më kërkon mua si prind të vij të kryej një gatim, po me çfarë do ta bëj unë atë? Ja një herë mund të marrë disa gjëra nga shtëpia, por kjo nuk mund të ndodhë gjithmonë.” (Prind, gjimnaz)*

*“Për një aktivitet praktik që bëhet në shkollë, unë si prind duhet të gjej llampën, telin, baterinë, gozhdën etj.” (Prind 9-vjeçare)*

### 5.6.3 Shkollat SHQK në kërkim të bashkëpunimeve që mbështesin realizimin e aktiviteteve

Ashtu siç u përmend edhe më lart, një ndër shqetësimet e vazhdueshme të ngritura nga mësues dhe drejtues është mungesa e fondeve për realizimin e aktiviteteve. Në shkolla të ndryshme janë bërë përpjekje të sigurohen këto fonde nga pushteti lokal, bizneset lokale, por mbi të gjitha nga organizata joqeveritare që veprojnë në zonën përkatëse. Duket se ka një varësi të dukshme nga mbështetja financiare e “donatorëve”. Ka një perceptim tek mësuesit dhe drejtuesit se vetëm shkollat që mbështeten nga organizata joqeveritare kanë mundësi të bëjnë aktivitete në kuadër të SHQK-së.

*“Duhet investim më i madh nga shoqatat. Drejtorja arsimore bashkë me shkollat komunitare duhet të koordinohen që të gjejnë shoqata që të financojnë aktivitetet e tyre.” (Mësues, zonë urbane)*

*“Vështirësia qëndron tek pamundësia e jetësimit të ideve për mungesë mbështetje nga hallkat lokale dhe mundësitë e kufizuara financiare të komunitetit dhe mësuesve. Sukseset në këto projekte qëndron vetëm tek gatishmëria e shoqërisë civile, pushtetit lokal dhe aktorëve të tjerë për të mbështetur konkretisht nismat, pasi idetë nga nxënësit nuk mungojnë.” (Fokus grup, mësues)*

#### **5.6.4 Paqartësi përsa i përket pagesës dhe normës**

SHQK-ja për mësuesit perceptohet si sforco e madhe marrë parasysh ngarkesën ekzistuese dhe detyrimet që ata kanë.

Nga diskutimi në fokus grupe janë evidentuar dy praktika të llogaritjes së ngarkesës së mësuesve për realizimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK-së: a) llogaritja e kohës së zhvillimit të aktiviteteve të SHQK si pjesë e normës mësimore të mësuesit dhe b) llogaritja e kohës së zhvillimit të aktiviteteve të SHQK mbi normën mësimore të përcaktuar të mësuesit.

Në pjesën më të madhe të shkollave të përzgjedhura, aktivitetet në kuadër të SHQK-së i realizojnë mësues të cilët plotësojnë normën e tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe në cilësinë dhe llojin e aktiviteteve që përzgjidhen. Kështu, edhe në rastet kur nxënësit propozojnë aktivitete, do të realizohen ato aktivitete që janë të mundura nga ana infrastrukturore dhe e kostove dhe nga mësues që janë nën normë. Në këtë mënyrë ngushtohet së tepërmi gama e zgjedhjes nga ana e nxënësve.

Mësuesit që realizojnë aktivitetet mbi normë dhe pa pagesë, e shikojnë realizimin e aktiviteteve si barrë të madhe. Kjo sforco në realizimin e aktiviteteve perceptohet nga nxënësit dhe ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e tyre.

*“Mësuesit janë heronj, unë i falenderoj me gjithë shpirt.” (Kordinator SHQK në DAR)*

Në të gjitha rastet nga ana e mësuesve, kërkohet pagesë financiare ekstra për orët ekstra të angazhimit të tyre në kuadër të SHQK-së, e zgjidhur kjo nëpërmjet: a) zbatimit të Udhëzimit nr. 44, datë 16.10.2014 i MAS sipas të cilit 10 orë në javë i dedikohen SHQK; b) pagesës së orëve ekstra në realizuara në kuadër të SHQK në fund të vitit; c) apo një mënyre tjetër. Drejtuesit në DAR/ZA kanë paqartësi për kuadrin në të cilin duhet të veprojnë.

*“Fillimisht, nuk u perceptua si një nismë apo si një sfidë serioze. Orët u ndanë nga drejtoresha sipas mundësive të mësuesve. Mbështetja dhe përkrahja në vitin e parë të punës nuk qe e plotë nga kolegët tanë. Arsyeya është sepse ne jemi në ajër. Ne themi hajde ti bëjmë këto dy orë që janë brenda normës time dhe të marr lekët.” (Fokus grup mësuesit)”.*

*“Mësuesit do të motivoheshin nga pagesa me bazë ore, sepse po ta llogarisësh me orët ekstra që ai do të bëjë, i bie që t’i dal një rrogë shtesë për vitin. Një motiv tjetër do të ishte dhe ulja e ngarkesës ekzistuese.” (Fokus grup, mësues)*

*“Mësuesit duhet të pagubën financiarisht. Ka ardhur Udhëzimi 44 i MAS sipas të cilit puna e 10 orëve për shkollën si qendër komunitare të pagubet. Por në korrik vjen një e-mail dhe thotë se Udhëzimi 44 i MAS në Tiranë nuk do të zbatohet sepse ka kosto të madhe për buxhetin. Mësuesit nga ana tjetër po punojnë, por nuk kanë asnjë garanci nëse do të pagubën.” (Drejtues, shkollë 9 –vjeçare)*

*“Na ka ardhur Udhëzimi ku 10 orë në javë i janë dedikuar aktiviteteve në kuadër të SHQK dhe u vendos që të angazhohen 5 mësues 2 orë në javë për SHQK, nëse kjo do të zbatohet, atëherë situata do të përmirësohet se pse do të kishim pesë kordinatorë brenda shkollës që do të merreshin me aktivitetet lidhur me SHQK.” (Drejtues, shkollë 9-vjeçare dhe gjimnaz)*

### 5.6.5 Ngarkesa lidhur me raportimet

Mësuesit dhe kordinatorët e SHQK në shkollë të intervistuar kërkojnë thjeshtëzim të raportimit dhe standardizim të tij. Sipas tyre raportimi i kërkuar nga DAR/ZA merr peshën kryesore të punës së tyre duke ndikuar në cilësinë e aktiviteteve.

*“Për ne është ngarkesë e madhe. Është raportimi që do të bëhet çdo muaj, por unë duhet të shkoj në çdo aktivitet që të shoh çfarë bëhet si edhe ta dokumentoj këtë me foto.” (Kordinator SHQK në shkollë)*

*“Tani ne duhet të mbajmë edhe regjistër për SHQK, është ngarkesë e madhe.” (Fokus grup, mësues)*

Ndërkohë, sipas intervistave të realizuara me përfaqësues të MAS, kërkohet vetëm një raport vjetor nga DAR/ZA në lidhje me mbarëvajtjen e SHQK. Faktikisht *Letër sqaruese e MAS për funksionimin e shkollës si qendër komunitare, datë 31.03.2014*, drejtuar DAR/ZA e përcakton si domosdoshmëri raportimin një herë në javë nga koordinatori i SHQK te koordinatori i DAR/ZA dhe nga koordinatori i DAR/ZA te koordinatori i MAS.

Ky aspekt mund të shërbejë për të reflektuar lidhur me çështjen e raportimit.

#### **5.6.6 Nevoja për trajnime të vazhdueshme**

Edhe pse janë realizuar trajnime nga IZHA dhe MAS si edhe është hartuar një udhëzues dhe praktik për të orientuar planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive të shkollës në bashkëpunim me komunitetin, një pjesë e mësuesve dhe drejtuesve të intervistuar (në pak shkolla) theksojnë nevojën për trajnime të vazhdueshme për të gjithë aktorët e shkollës si edhe ofrimin e modeleve konkrete të mënyrës se si duhet të punojnë.

*“Kemi patur vështirësi sepse nuk kemi patur një model apo një shembull të qartë për mënyrën sesi të organizoheshim. Na nevojiten më shumë materiale praktike për shkollën komunitare. (Koordinator SHQK shkollë)”*

#### **5.6.7 Mekanizmi i propozimit dhe planifikimit të aktiviteteve**

Planifikimi i aktiviteteve nga çdo shkollë bëhet bazuar në fushat e standardeve të SHQK të miratura nga MAS. Përgjithësisht mekanizmi në praktikë funksionon si më poshtë:

Në pjesën më të madhe të shkollave nxënësit ftohen të propozojnë aktivitetet që do të dëshironin të realizonin (brenda fushës/fushave të përzgjedhura për t'u fokusuar). Në përgjithësi, opinionet e nxënësve janë marrë nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të nevojave/dëshirave. Vetëm në dy shkolla, e njëjta praktikë është ndjekur dhe me prindërit (pra janë vlerësuar edhe nevojat e prindërve). Propozimet e nxënësve më pas janë ballafaquar me mundësitë dhe kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore që ka shkolla. Pra, pavarësisht propozimeve të nxënësve, shkollat janë të kushtëzuara që të zhvillojnë ato aktivitete që janë të mundshme për t'u realizuar marrë parasysh burimet njerëzore dhe fizike ekzistuese.

Ka edhe raste kur aktivitetet ideohen dhe propozohen nga koordinatori i shkollës për SHQK, drejtues apo mësues të ndryshëm pa u konsultuar drejtpërdrejt me nxënësit, prindërit apo edhe me aktorë të tjerë të shkollës.

Pra ajo që vihet re në të gjitha shkollat është se ka hapësirë për përmirësimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve në konceptimin dhe planifikimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK.

Shkolla ka realizuar një aktivitet shumë interesant me nxënësit në kuadër të SHQK dhe ata pyeten gjatë fokus grupit: *“E kujt ishte kjo ide? E drejtoreshës sigurisht. Po nxënësit si e pritën? Shumë mirë, u kënaqën edhe prindërit e pritën akoma më mirë”*. (fokus grup me mësues, shkollë 9-vjeçare)

### 5.6.8 Koha përgatitore për aktivitetet

Një ndër problemet që artikulojnë mësuesit lidhet me mënyrën e matjes së orëve punës në kuadër të SHQK-së. Ata theksojnë se shpenzojnë shumë orë parapërgatitore për realizimin e aktiviteteve edhe pse aktiviteti në vetvete që realizohet me nxënësit mund të jetë disa orë. Shqetësimi qëndron në faktin se si mund të raportohen orët përgatitore për aktivitetet?<sup>2</sup>

*“Nuk merret parasysh koha që shpenzon mësuesi për SHQK-në. Unë mund të bëj dy orë aktivitet por ato nuk janë realisht dy orë. Kam shpenzuar shumë orë përgatitore për aktivitetin në fjalë.”* (Fokus grup me mësuesit)

### 5.6.9 Koha e realizimit të aktiviteteve

Pavarësisht se SHQK presupozon hapjen e shkollës përtej procesit mësimor, një problem që theksojnë specifikisht mësues, koordinatorë, nxënës dhe prindër në shkollat rurale është distanca e shkollave me vendbanimin e mësuesve dhe nxënësve dhe mungesa e mjeteve të transportit, gjë që e vështirëson shumë realizimin apo ndjekjen e aktiviteteve. Edhe në disa shkolla 9-vjeçare në zona urbane, çështja e realizimit të aktiviteteve mbas mësimin është ngritur si problem pasi prindërit nuk kanë mundësi t'i shoqërojnë fëmijët edhe mbas mësimin dhe t'i presin sa ata të mbarojnë.

*“Në zonat rurale përveç mosinteresimit, ka dhe faktorë të tjerë objektivë si për shembull largësia nga shkolla. Të gjitha veprimtaritë që mund të bësh nëpër shkolla rurale duhen bërë brenda orarit sepse më pas nxënësit do largohen bashkë me mësuesit për arsye të transportit.”* (Drejtues, shkollë 9-vjeçare)

### 5.6.10 Bashkëpunimi dhe marrëveshjet ndërinstitucionale

---

<sup>2</sup> Aq shqetësues ishte ky zë për mësuesit, saqë në më shumë se katër fokus grupe të realizuara, moderatorët e fokus grupeve janë pyetur nga mësuesit nëse mund ta konsideronin si orë aktiviteti kohën e shpenzuar prej tyre në fokus grup.

Nga fokus grupet dhe intervistat mësues, drejtues dhe koordinatorë në DAR/ZA theksuan rëndësinë që ka bashkëpunimi institucional midis shkollës dhe strukturave/institucioneve të tjera të nivelit qendror dhe lokal. Por këto institucione të tjera duket se pak ose aspak janë të informuara në lidhje me nismën SHQK. Nëse do të funksionte ky bashkëpunim shkollat do ta kishin më të lehtë realizimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK.

*“Kemi dashur të bëjmë një aktivitet dhe kemi kërkuar të përdorim mjediset e një qendre kulturore publike dhe për këtë na është kërkuar pagesë qiraje për sa orë do ta përdornim. Tani shkolla është qendër komunitare, është publike dhe nëse bëhet një marrëveshje me MASH ato mjedise ne mund t’i marrim falas.”*

*“Të ndihmohet shkolla në infrastrukturë, d.m.th. nëse Bashkia ka një specialist, ta sjelli këtu, t’i japi stimuj të tjerë atij me taksa më të ulëta etj.”*

*“Duam bashkëpunim me pushtetin vendor.”*

*(Citime nga fokus grupe të ndryshme me mësues)*

#### 5.6.11 Përfshirja dhe motivimi i mësueseve

Për të siguruar përfshirjen e sa më shumë mësuesve në nismën SHQK si dhe për t’i motivuar ata, MAS me anë të Udhëzimit nr.44, datë 16.10 2014, krijoi mundësinë që orët e veprimtarive në kuadër të SHQK të ishin pjesë e normës mësimore të mësuesve që i zhvillonin këto veprimtari. Kjo lloj nisme mbështetet nga ata mësues dhe drejtues shkolle që i shikojnë orët e shpenzuara për aktivitetet e SHQK si mundësi e mirë për të plotësuar normën e një pjese të stafit që mund të jenë nën normë.

Një pjesë tjetër e mësuesve (ata të cilët e plotësojnë normën) e shikojnë pagesën ekstra për orët e shpenzuara në kuadër të SHQK si një motiv shumë i mirë që i nxit për t’u për përfshirë në kuadër të SHQK.

Një pjesë tjetër e mësuesve propozojnë që aktivitetet në kuadër të SHQK-së të realizohen nga mësues të tjerë (kundrejt incentivave financiarë) të cilët nuk janë pjesë e organikës ekzistuese. Sipas tyre edhe në rast se mësuesit janë pjesë e organikës ekzistuese dhe do të paguheshin ekstra për angazhimin e tyre në SHQK, ata nuk janë të motivuar, marrë parasysh detyrimet e tjera që ata kanë.

*“Unë do të rekomandoja që të përfshiheshin mësues shtesë. Ka shumë mësues që janë të papunë, ata mund të merren me këto aktivitete dhe në këtë mënyrë ata do të ndihen të përfshirë. Duke marrë këta mësues, barra nuk i bie atij mësuesi që rri tërë ditën në punë. Është shumë e lodhshme të punosh edhe me pagesë pas orës 14.00.” (Mësues gjimnazi)*

*“Mbingarkesa është problem. Nëse një shkollë komunitare do mbabeh hapur deri në orën pesë, çfarë do*

*bënim ne mësuesit që edhe tani jemi shumë të ngarkuar? Nuk ka motivim për mësuesit dhe kushte në shkollë. Duke qënë se mësues të papunë ka goxha, unë do sugjeroja që të emëroheshin disa mësues që të merreshin me organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve në shkolla të ndryshme, kundrejt një page të caktuar. Sepse një mësues që jep mësim 5-6 orë në ditë nuk ka fuqi që të qëndrojë dhe 2-3 orë më pas.” (Mësues gjimnaz)*

*“Mua më duket se mësuesit që punojnë aty në SHQK e kanë peshë bërjen e aktiviteteve. Ti kërkosh atij që bën gjashtë orë mësim të rrijë dhe dy orë të tjera me fëmijët është mbingarkesë.” (Fokus grup, prindër)*

*“Si unë si mësuese dhe nxënësit e kemi me përtesë të vijmë mbasdite.” (Fokus grup, mësuese)*

*“Unë kam qënë prezant kur kryetari i Komunës i ka ofruar mësuesve pagesë për të qëndruar në shkollë pasdite për të realizuar aktivitete në mbështetje të nxënësve dhe mësuesit nuk erdhën.” (Fokus grup, mësues)*

Megjithëse të paktë në numër disa mësues pjesëmarrës në fokus grupe theksuan rëndësinë e madhe që ka dëshira e vetë mësuesve për të kontribuar dhe bërë diçka të mirë për shkollën dhe komunitetin përtej pagesës.

*“Nuk është tek pagesa, është tek dëshira. Dëshira është kryesorja.” (Mësuese)*

*“Të ndryshojë edhe struktura e vetë nismës së SHQK, që unë t’i bëj gjërat me kënaqësi dhe jo me detyrim – mësueset të shpërblehen për ato 2 orë, të krijohen mjediset e punës dhe të ketë bazë materiale.”*

*(Fokus grup, mësues)*

Në një SHQK 9-vjeçare titulli i tabelës ku ishin ekspozuar aktivitetet e realizuara në kuadër të SHQK ishte “Ta ndajmë së bashku ëndrrën”. Mësuesja që e kishte realizuar këtë poster me foto dhe titullin shpjegon “... e konsideroj ëndërr këtë nisëm, sepse është si diçka që kemi dëshirë ta realizojmë, si një ëndërr që dubet ta bëjmë realitet.”

#### **5.6.12 Përfshirja e prindërve/komunitetit**

Marrë parasysh mungesën e praktikave të ngjashme më parë, nga të gjithë grupet e të intervistuarve vihet re se shkollat janë vetëm në hapat e parë të një procesi të gjatë të vendosjes së urave të shëndosha të komunikimit midis shkollës-familjes dhe komunitetit.

Shumë pak prindër e kuptojnë konceptin e SHQK-së dhe jo vetëm që nuk marrin pjesë vetë në këto aktivitete (aktivitete në mbështetje të komunitetit ose aktivitete ku komunitetit i kërkohet të mbështesë në forma të ndryshme), por nuk lejojnë dhe fëmijët e tyre që të qëndrojnë në to.

*“Është pak e vështirë të përfshihesh prindërit, por ne përpiqemi me ata pak prindër që janë më të gatshëm. Por pesha ka rënë mbi mësuesin. Nxënësi e bën për ne” (Fokus grup, mësuese)*

Në përgjithësi prindërit janë në pozita pritëse, nëse ftohen të marrin pjesë në aktivitete një pjesë e tyre, thjeshtë vijnë. Edhe në ato raste kur prindërit kanë marrë pjesë në aktivitetet e realizuara në kuadër të SHQK, ata janë thjesht pjesëmarrës, por jo të jenë angazhuar për të ndihmuar në një mënyrë apo tjetër në realizimin e aktivitetit. Një kategori tjetër prindërisht, sipas fokus grupeve të realizuara, janë indiferentë ndaj mbarëvajtjes së nxënësve në shkollë dhe për më tepër duken akoma më pak të interesuar për aktivitetet ekstrakurrikulare, kjo më tepër evidente në shkollat e mesme.

*“Prindërit vijnë kur i ftojme në aktivitete, jo të gjithë sigurisht...por puna është që ata të mos jenë përzier si spektatorë, por të jenë aktivë sepse kanë fëmijën e tyre aty, të bëhen një me shkollën.” (Fokus grup, mësues)*

*“Kemi qënë në takime me prindërit dhe më shumë se 50% e tyre kanë munguar. Jo më të vijë prindi mbasditë të marri pjesë në aktivitete. (Fokus grup me prindër, gjimnaz)*

Ka një dallim esencial ndërmjet faktorëve objektivë që pengojnë prindërit dhe komunitetin të marrin pjesë në aktivitete të SHQK-së në shkollat në zonat rurale dhe urbane. Prindërit dhe komuniteti në shkollat rurale janë shumë më pak të interesuar për shkollën dhe kanë pritshmëri reale nga fëmijët e tyre që të angazhohen në punët e familjes, kryesisht në bujqësi. Ndërkohë që prindërit në zonat urbane problemin kryesor kanë mungesën e kohës si pasojë e angazhimit me punë apo jetës stresante.

*“Po ata prindërit në fshat mendojnë që ato dy orë fëmija mund ta ndihmojë me punë, i shfrytëzojnë për punë shtëpie dhe bujqësi.” (Fokus grup, prindër)*

*“Drejtori na ka thënë që të realizojmë orët komunitare pas mësimit ose në fundjavë. Por nxënësit janë 2-3 kilometra larg me vendbanim. Nuk ka kushte sesi fëmijët do vijnë apo sesi do të kthehen përsëri në shtëpi sepse furgonat iu nisen me orare të përcaktuara. Ka madje dhe nxënës që e kanë shkollën një orë e gjysmë larg.” (Mësues, shkollë 9-vjeçare në zonë rurale)*

*“Prindërit janë në punë për vetë. Nuk kanë kohë, kanë një jetë stresante. Ne kemi goxha prindër intelektualë në shkollën tonë të cilët janë në orare pune shumë të gjata.” (Fokus grup, prindër)*

Nga fokus grupet dhe intervistat me prindër, nxënës, por edhe mësues duket se një arsye tjetër përse një pjesë e madhe e prindërve nuk janë të përfshirë është edhe fakti se prindërit ende nuk kanë arritur të kuptojnë thelbin dhe rëndësinë që ka kjo iniciativë për fëmijët e tyre, përfitimet e drejtpërdrejta dhe ato indirekte për fëmijët e tyre dhe për vetë ata.

*“Unë mendoj se është diçka e re dhe ka nisur pak vonë dhe komuniteti nuk është mësuar...kjo nuk është bërë më përpara dhe nuk kanë eksperiencë në këtë drejtim dhe e kanë të zorshme sepse shkollat për vite kanë qenë të mbyllura. (Fokus grup, nxënës)*

*“Në fakt po bëhet diçka eksperimentale dhe komuniteti akoma nuk është mësuar me këtë gjë. Në shkollën tonë kemi fushe volejboli, futbollit dhe basketbollit, përse të paguben para në kurse private kur anëtarët e komunitetit mund të vijnë dhe të përdorin mjediset e shkollës?” (Fokus grup, nxënës gjimnaz)*

*“Kur ja prezantuam prindërve idenë e SHQK, njëri prej tyre më tha: “Unë kam tre fëmijë, a mund të m’i bësh kurse mbas mësimit. Ja shpjegova dhe i thashë që kjo nisëm është që edhe ti si prind të vish të na ndihmosh të paktë një herë në javë. Asnjë prind nuk e bën këtë.” (Fokus grup, mësues)*

*“Dubet të bëjmë sensibilizimin e prindërve duke filluar me fletushka. Fëmijët t’ja çojnë prindërve në mënyrë që ata ta kuptojnë vërtetë se çfarë është SHQK. Kur prindërit nuk e dinë ata nuk kanë arsye përse do të vijnë.” (Fokus grup, mësues)*

*“Prindërit nuk e ndiejnë vërtetë shkollën si qendër komunitare. Pra dubet një promovim akoma dhe më i madh. Prindërit i shohin këto si aktivitete që i ka shkolla, jo si aktivitete edhe për ata.(Fokus grup, nxënës)*

Nisur nga eksperiencat e mëparshme, jashtë SHQK, në kuadrin e aktiviteteve të ndryshme (rregullime brenda klasës, festa etj.) prindërve u është kërkuar të japin një mbështetje të vogël financiare. Në këtë kontekst disa prej prindërve të intervistuar, kishin perceptimin se edhe në rastin e aktiviteteve të SHQK, mësuesit do t’i kërkojnë mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve (edhe pse kjo praktikë nuk ka ndodhur realisht në asnjë nga shkollat ku është realizuar vlerësimi). Si pasojë e këtij keqperceptimi, motivacioni i prindërve për të marrë pjesë është më i ulët.

*“Ndodh dhe diçka tjetër, sa herë ne vijmë si prindër në mbledhje prindërishe, mësuesit kërkojnë që ne të kontribuojmë para për këto aktivitete apo për diçka tjetër. Prindërit kur dalin nga dera fillojnë duke thënë që këta (mësuesit) vetëm para duan, kushedi i mbajnë për vete e kështu gjërash.” (Fokus grup me prindër)*

*“Gjëja që ne dubet të bëjmë është të bëjmë më shumë takime me prindër që t’i shpjegojmë atyre që prindërit janë të rëndësishëm dhe jo paratë e tyre. Sepse ndoshta ka pasur dhe nxënës që nuk kanë ditur t’ia shpjegojnë prindërve se çfarë është kjo nismë.” (Fokus grup, mësues)*

Gjithashtu, duket se ka ende shumë për të bërë në lidhje me vendosjen e urave të komunikimit midis shkollës dhe komunitetit përsa i përket përdorimit të burimeve ekzistuese si edhe gjetjes apo plotësimit të atyre që mungojnë. Duket që në të shumtën e rasteve mësuesit dhe nxënësit ulen së bashku dhe diskutojnë në ç'formë mund të ndihmojnë komunitetin duke supozuar nevojat e mundshme që komuniteti i tyre mund të ketë. Edhe në ato pak shkolla që kanë ndërmarrë iniciativën të vlerësojnë nevojat/dëshirat e prindërve paraprakisht me pyetësorë dhe bazuar në to të organizojnë aktivitete të ndryshme prindërit nuk kanë marrë pjesë.

Ndërkohë që nevojitet një i kuptuar më i thellë dhe më i vërtetë i asaj se çfarë mund t'i nxisë prindërit të bëhen pjesë e nismës.

*“Kjo është pengesë e madhe ngaqë komuniteti nuk ka shumë informacion në lidhje me këtë nismë, ai nuk shtron kërkesat e tij, nëse ai do t'i shtronte kërkesat atëherë edhe ne do të dinim se ku të fokusoheshim. Këto janë ide që ne i kemi shprehur duke menduar se do t'i interesonin komunitetin.” (Fokus grup, mësues)*

*“Ne kemi bërë pyetësorë për të kuptuar se çfarë nevojash kanë, ne e hartuam vetë, fëmijët ja çuan prindërve dhe e sollën pyetësorin përsëri në shkollë. Ne i kemi çuar letra me shkrim prindërve, u kemi bërë ftesa që të vijnë të shfrytëzojnë palestrën, bibliotekën, sallën e informatikës, por interesimi nuk është aspak i lartë. Është bërë njoftimi që shkolla ofron aktivitete falas duke përcaktuar orarin dhe fundjavat, por përsëri nuk ka interes.” (Fokus grup mësues, shkollë 9-vjecare)*

*“Dubet të zhvillohen takime apo festa ku në qendër të jetë prindi, për t'i treguar vlerën që ata kanë.” (Fokus grup, nxënës)*

*“Këtë vit do t'i mësojmë më shumë aktivizimit të fëmijës, sepse duke nxitur fëmijën që të aktivizohet, do të aktivizohet edhe prindi. Këtë mund ta bëjmë duke i dhënë detyra dhe përgjegjësi secilit nxënës, jo vetëm disave. (Fokus grup me nxënës)*

### **Dallimi në përfshirjen e prindërve**

Duket se ka një korrelacion ndërmjet moshës shkollore të fëmijëve dhe interesimit të prindërve. Sa më të vegjël fëmijët në moshë shkollore aq dhe më shumë të lidhur janë prindërit me shkollën, aq më të interesuar janë ata për të bashkëpunuar me shkollat. Ndërkohë që e kundërta vihet re në gjimnaze.

*“Nxënësit e fillores dhe prindërit e tyre janë më bashkëpunues se ata të gjimnazit. Në gjimnaz prindërit nuk vijnë në takim me prindër dhe jo më në aktivitetet e SHQK-së. (Kordinator zonë urbane)*

*“Unë kam vajzën dhe fëmijët janë shumë të kënaqur me aktivitetet e shkollës. Janë organizuar disa aktivitete dhe kemi kaluar disa mbasdite të mrekullueshme.” (Fokus grup, prindër, 9-vjecare)*

Në të gjithë fokus grupet me prindër, mësues, nxënës dhe koordinatorë, pjesmarrësit bien dakord që interesi i prindërve të nxënësve që kanë rezultate të larta në shkollë është shumë më i madh krahasuar me prindërit e nxënësve më rezultate të ulëta.

Ky grupim prindëror është shumë më i interesuar për aktivitete të karakterit akademik (kurse të avancuara në lëndë të ndryshme si matematikë, biologji) dhe përmirësimit të aftësive të fëmijëve të tyre (në anglisht, kompjuter).

*“Me pjesmarrjen e prindërve ka një problem. Prindërit që kanë fëmijë që janë shumë të mirë në shkollë janë më të preokupuar. Nga ana tjetër ka prindër që nuk dinë në çfarë klase e kanë fëmijën dhe kë mësues kanë.” (Fokus grup me prindërit)*

*“Prindërit më pasivë rezultojnë të jenë ata që kanë fëmijët me rezultate të dobëta dhe suksesi më i madh do të ishte aftësia për të tërbequr si të thuash këta prindër në çështjet e shkollës.” (Fokus grup me mësues)*

### 5.6.13 Përfshirja e nxënësve

Nga bisedat e drejtpërdrejta me nxënës u vu re se një pjesë e tyre e kanë kuptuar mirë konceptimin e SHQK, janë tepër aktivë dhe karakterizohen nga dëshira për të bërë gjëra dhe nga idealizmi (karakteristikë kjo edhe tipike e moshës së adoleshencës). Shtysat apo faktorët që i nxisin këta nxënës, kryesisht burojnë së brendshmi nga dëshira e tyre për protagonizëm, lidhshmëri, për të marrë pjesë në aktivitete si edhe për të kontribuar. Një pjesë e vogël raportojnë se kanë si shtysë familjen dhe mënyrën si janë edukuar.

*“Unë marr pjesë në këtë aktivitet sepse nëse do ta shohim shkollën vetëm si akademike ajo do të bëhet monotone, po të bëjmë aktivitete e prishim pak atë monotoninë.”*

*“Për të rritur mbarëvajtjen e shkollës sonë, për ta bërë atë multifunksionale”.*

*“Nuk dubet ta shohim vetëm si rritje të shkollës sonë, por edhe të komunitetit. Ne dubet t'i gjendemi për shembull gjithmonë pranë komunitetit rom jo vetëm në disa raste”.*

*(Citime nga fokus grupe të ndryshme me nxënës)*

Nga fokus grupet dhe intervistat e realizuara raportohet se një pjesë e konsiderueshme e nxënësve janë indiferentë apo nuk marrin pjesë në aktivitetet në kuadër të SHQK. Pengesat në këtë drejtim janë të lidhura me faktin se një pjesë e nxënësve janë të angazhuar në kurse private, kanë detyra dhe mësim për të nesërmen dhe kjo i kufizon ata nga marrja pjesë në aktivitete që zhvillohen mbas orarit të mësimt. Një pjesë tjetër kanë problemin se nuk lejohen nga prindërit për të marrë pjesë për efekte sigurie (sepse ata duhet t'i shoqërojë dikush, t'i sjellë dhe marrë nga shkolla). Një pjesë tjetër e nxënësve janë neglizhentë, nuk shfaqin interes. Qëndrimi i nxënësit

dhe rëndësia që ai i jep këtyre aktiviteteve sigurisht që afekton edhe qëndrimin dhe për pasojë edhe pjesëmarrjen e prindërve. Sipas nxënësve të intervistuar, neglizhenca apo mungesa e interesit mund të vijë si pasojë e mungesës së besimit se ai/a jo mund të japë një kontribut, apo si pasojë e faktit se këta nxënës kanë nevojë për një shtysë/nxitje më të fortë nga jashtë në mënyrë që të marrin pjesë apo të kontribuojnë.

Në këtë kuadër, edhe pse qeveritë e nxënësve kanë patur në pjesën më të madhe të shkollave një rol aktiv në kuadër të SHQK – ka shumë hapësirë për t'u përmirësuar me qëllim përfshirjen e një numri sa më të madh nxënësish që në konceptimin, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve.

*“Ndoshta dhe familja e tyre nuk e pëlqen faktin që fëmija të jetë pjesëmarrës në të tilla aktivitete. i kërkojnë që të fokusohen vetëm tek mësimet.” (intervistë, nxënës)*

*Duke qenë se është ngarkesë e madhe mësimore, mendoj se duhet të gjendet një orar i përshtatshëm për kryerjen e këtyre aktiviteteve me qëllim që të vijnë të gjithë, jo disa të vijnë dhe disa të mos vijnë.” (Fokus grup, nxënës)*

*“Tek prindërit është frika sesi mund ta lënë fëmijën të vijë vetëm mbase në shkollë.” (Fokus grup, nxënës 9-vjeçare)*

*“Për mua e gjitha qëndron tek rëndësia që nxënësi i jep aktivitetit” (Fokus grup, nxënës)*

*“Unë mendoj që ata mendojnë se ndihma që do të jap unë është shumë e pakët, ata mendojnë se unë jam një dhe nuk mund t'i vlejë ndihma ime.” (Fokus grup, nxënës)*

Nga fokus grupet dhe intervistat e realizuara me nxënës, rezulton se nga të gjithë nxënësit që marrin pjesë në aktivitetet e SHQK-së ata të klasave të nënta dhe vitit të tretë gjimnaz dallojnë në interesin e tyre për kurse të avancuara në lëndët që përkujnë me provimet në fund të vitit. Duket se ata kanë vështirësi të marrin pjesë në aktivitete ekstrakurrikulare, por janë më tepër të interesuar të ndjekin konsultimet me lëndë të caktuara në të cilat ata kanë nevojë, që realizohen në kuadër të SHQK. Janë pikërisht këto kurse të avancuara akademike të cilat nëse nuk do të ofrohen në kuadër të SHQK, do të merren privatisht jashtë shkolle. Edhe në këtë rast bëhet një dallim i qartë në interes ndërmjet nxënësve të mirë dhe më të dobët.

*“Ja unë kam fëmijën maturant dhe do të konkurroj për universitet në degën biologji- kimi. Po mendoj se i nevojitet dhe informacion tjetër, nuk mund të mjaftohet vetëm me ato që mëson në shkollë. Unë them do të ishte mirë që të bëhej një grup që do të konkurroj në këtë drejtim dhe të bëjnë kurse në shkollë për biologji dhe kimi. (Fokus grup, prindër)*

## 5.7 Grupet e marxhinalizuara

Kryesisht në perceptimin që kanë të gjitha palët, shpesh këto grupe barazohen me romët, egjiptianët dhe nxënësit me aftësi të kufizuara. Janë realizuar një sërë aktivitete në shkollat që kanë brenda tyre fëmijë të këtyre komuniteteve dhe nga të gjitha palët e intervistuar perceptohen si aktivitete të suksesshme. Vetë nxënësit që vinë nga këto grupime kanë qënë pjesë aktive e këtyre aktiviteteve. Nëpërmjet kësaj iniciative vihet re se grupet në nevojë janë më tepër në qendër të vëmendjes, është rritur ndërgjegjësimi i aktorëve të ndryshëm në lidhje me ta, si edhe është lehtësuar aksesimi apo janë krijuar më tepër mundësi për ta.

Megjithëse grupet vulnerabël kanë përfituar shumë nga aktivitetet e ndryshme të realizuara, nga intervistat dhe fokus grupet rezultoi se ata kanë qënë pak të përfshirë në fazën fillestare (konceptimin, identifikimin e nevojës dhe planifikimin të mënyrave për t'i adresuar ato).

*“Këtë vit kjo gjë është shtuar më shumë, por tek shkolla jonë kjo gjë ka qënë vazhdimësi edhe pa u prezantuar kjo nismë.”*

*(Fokus grup, nxënës)*

*“Edhe në rastet kur SHQK-ja nuk arrin të përmbushë nevojat e grupeve vulnerabël me mundësitë e saj, ajo shërben si zëdhënës në një farë mënyre i interesit të këtyre grupeve duke kërkuar nga institucionet përkatëse të bëjnë më shumë në drejtim të përmirësimit të situatës për këto grupime*

*(Fokus grup, mësues)*

*“Sa i përket romëve, ata absolutisht që sot shihen me një sy tjetër, pasi më përpa ata etiketoheshin me pa të drejtë ngaqë kryenin punë kryesisht të rëndomta, por promovimi i tyre në aktivitetet u ka dhënë atyre shumë prestigj dhe neve na ka shërbyer të kemi këndvështrim tjetër për ta nga ku kemi kuptuar se ngjyra e lëkurës është fare e parëndësishme para vlerave reale që pasqyrojnë një individ apo një grupim.*

*(Nxënës gjimnazi)*

*“Aktivitetet e realizuara në shkollën e fëmijës tim kanë qënë shumë të vlefshme. P.sh vitin e shkolluar për festat e fundvitit fëmija im bashkë me shokët e klasës shkuan tek jetimoret dhe u falën fëmijëve jetim lodra të ndryshme dhe veshje. Kur erdhi fëmija në shtëpi ndjente shumë kënaqësi. Aty kuptoi se çfarë kishte vet dhe çfarë i mungonte atyre fëmijëve*

*(Prind, shkollë 9-veçare)*

*“Vjet për një nxënës që është me aftësi të kufizuara, ne krijuam kushtet për të studiuar, e vendosëm në një klasë në kat të parë, iu krijua hapësira e nevojshme dhe duke qënë se kishte dhe vështirësi në të nxënë atij iu ofruan dhe orë ekstra.”*

*(Mësues, shkollë 9-veçare)*

*“Ne kemi mbledhur disa fonde dhe kemi blerë dhurata për fëmijët me të ardhura të pakta.”*

*(Nxëns, shkollë 9-vjeçare)*

*“Para një viti ne kemi zhvilluar një aktivitet nën logon “Jemi të barabartë”, ku morrën pjesë fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian si dhe dy fëmijë me aftësi të kufizuara.”*

*(Nxënëse, shkollë 9-vjeçare)*

*“Çdo ditë në shkollën tonë dy nxënëse, ose më shumë pas mësimit mundohemi që të mësojmë romët, t'i mbështesim me bërjen e detyrave të shtëpisë dhe mësimit, i sjellim lapsa, ngjyra sipas mundësive që kemi. Ka raste nëse pranojnë i japim mësime edhe në shtëpi.”*

*(Nxënëse shkollë 9-vjeçare ku ka komunitet rom)*

## 6. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SHQK

Transformimi i shkollës në “shkollë si qendër komunitare” duhet të perceptohet nga të gjithë aktorët e përfshirë si një proces, që kërkon kohën e vet. Po ashtu, ky është një proces i lidhur ngushtë me ndryshimin e mentalitetit dhe qëndrimet e aktorëve të përfshirë drejtpërdrejt apo indirekt mbi mënyrën sesi perceptohen fëmijët/të rinjtë, mbi rolin e shkollës dhe krijimin e urave të bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet.

Më poshtë parashtrojmë një sërë rekomandimesh që vijnë si rezultat i kombinimit të shqyrtimit të literaturës, analizës së praktikave pozitive në botë dhe mësimëve të nxjerra nga pilotimi i deritanishëm i SHQK në vend, si edhe nga sugjerimet e bëra nga aktorët e përfshirë në relizimin e kësaj nisme.

### Fokusi i nismës

Së pari, është e nevojshme të unifikohet terminologjia lidhur me SHQK. Ne rekomandojmë që të përdoret termi *program* si më i përshtatshëm për këtë ndërmarrje pasi *nisma* dhe *projekti* nënkuptojnë ndërmarrje më të kufizuara në përmbajtje dhe kohë, aq më tepër që *nisma* shihet si hap i parë i një veprimi, a plani; *lëvizja* nuk është term i përshtatshëm për përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj ndërmarrjeje dhe fjala *qasje* në kuptimin e metodës dhe procedurës nuk është fjala e përshtatshme për të shprehur qëllimin dhe përmbajtjen e SHQK.

*Shkolla si qendër komunitare* do të ishte mirë që të prezantohej si një *program zhvillimi* që synon të realizojë një nga objektivat e reformës së arsimit parauniversitar. Ky program të riorganizohet në disa dimensione dhe të realizohet nëpërmjet një sërë projektesh.

Së dyti, duke qenë se materialet teorike e kanë vënë theksin më shumë në aktivitetin e shkollës, dhe konkretisht në veprimtari përtej procesit mësimor; ato kanë qenë pak mbështetëse për të kuptuar dhe zbatuar në praktikë partneritetin e aktorëve të ndryshëm dhe përfshirjen e komunitetit, rekomandojmë që të realizohet një ridimensionim teorik duke mbajtur parasysht këto konsiderata teorike:

- a. Shkolla në vetëvete është një komunitet që përbëhet nga nxënësit, mësuesit dhe profesionistët e tjerë që punojnë në shkollë, që krijon sensin e komunitetit midis nxënësve, që krijon shpirtin e nxënësve, që është një marrëdhënie midis të barabartëve, që siguron mbështetjen e mësuesve, psikologëve, punonjësve social, mjekëve, që krijon sensin e drejtësisë dhe që garanton zërin e nxënësve. Por ajo është një komunitet për të nxënë dhe duhet të zhvillohet si një komunitet i të nxënësve gjithashtu. Kjo konsideratë e vë theksin në zhvillimin e shkollës si komunitet dhe zhvillimin e shkollës si komunitet i të nxënësve. Kështu kemi pasurimin e SHQK me dy dimensione të reja që sigurojnë realizimin e objektivit për një shkollë cilësore.

b. Shkolla dhe komuniteti krijojnë një partneritet me dy kahje: shkolla që tërheq komunitetin në shkollë dhe komuniteti që e tërheq shkollën në komunitet.

- Qasja e parë realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me shoqatat e prindërve dhe të mësuesve, programeve pas shkolle dhe veprimtarive jashtëkurrikulare; nëpërmjet angazhimit të komunitetit (familjes, bizneseve, agjencive, qeverisjes vendore) për shkollën duke ofruar shërbime për nxënësit; nëpërmjet vullnetarizmit, bashkëpunimit në marrjen e vendimeve dhe bashkërendimit të burimeve.
- Qasja e dytë realizohet nëpërmjet tërheqjes së shkollës në komunitet dhe shkolla ndihmon prindërit për përmbushjen e rolit të prindit, ofron mësimin në shtëpi, ofron shërbime për familjen dhe komunitetin nëpërmjet qendrës burimore për familjen, qendrës së të nxënësve për komunitetin; qendrës për shërbimet komunitare.

Që dy aspektet më lart të vihen natyrshëm në praktikë duhet të krijohet një platformë e përbashkët veprimi. Aspekti që mundëson bashkimin e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme është ndarja e një vizioni të njëjtë mbi atë se çfarë u duhet fëmijëve dhe të rinjve që të zhvillohen pozitivisht në të gjitha aspektet. Krijimi i një konsensusi të përgjithshëm publik mbi këtë çështje do të nxiste dhe mobilizonte qytetarët, shkollat, familjet, lagjet, komunitetet, organizatat e të rinjve, institucionet dhe struktura të tjera për të vepruar.

### **Partneriteti shkollë-familje-komunitet**

- Kryefjala e nismës “Shkolla si qendër komunitare” është partneriteti, por nga vlerësimi ky aspekt rezulton se ka nevojë të përmirësohet apo të thellohet më tej. Prandaj një grup rekomandimesh lidhen me partneritetin:
  - Që nisma SHQK të jetë e efektshme kërkohet të realizohet një bashkëpunim dhe partneritet real, konkret, veprues, të krijohet një rrjet i të gjithë aktorëve (mësues, nxënës, prindër, persona kyç nga komuniteti, përfaqësues pushteti lokal, OJF, biznesi etj.) i cili jo vetëm do të kishte të përcaktuar qartë vizionin dhe do të kishte një udhëheqje të fortë, krijuese, të efektshme, por do të duhej të njihnte rolin e gjithësecilit aktor, do të duhej të pranonte se secili aktor ka një rol kyç në këtë bashkëpunim për të arritur synimet e përbashkëta. E rëndësishme është që ky rrjet duhet të bashkëpunojë duke ndarë përgjegjësitë, respektuar diversitetin dhe përdorur burimet dhe kapacitetet. Në këtë kuadër ndihmuese do të ishte që të përgatitej një paketë me strategjitë e efektshme të bashkëpunimit dhe partneritetit për SHQK. Gjithashtu, tepër ndihmuese do të ishte organizmi i takimeve me të gjithë aktorët në lidhje me krijimin e një vizioni të përbashkët mbi atë se çfarë u duhet fëmijët dhe të rinjve për t’u rritur dhe zhvilluar pozitivisht.
  - Partneriteti duhet të përqendrohet në përdorimin e të gjitha burimeve sipas qasjes kosto-efektivitet duke përdorur një qasje të integruar për të adresuar nevojat komplekse të nxënësve, familjeve dhe komunitetit. Kjo do të thotë që të përdoren si

burimet publike dhe ato private. Për këtë nevojitet që të gjitha palët të mbështesin një qasje tërësore, gjithëpërfshirëse duke bashkërenduar burimet që shmangin mbivendosjet, paralelizmat dhe inefektivitetin.

- Partneriteti kërkon një tërësi politikash kohezive që do të përqëndrohen në vendimmarrje të përbashkët; në krijimin e ekipeve të ndryshimit dhe të agjentëve të ndryshimit që do të realizojnë ndryshimet sistematike; në krijimin e mekanizmave për të menaxhuar burimet, në sigurimin e fondeve për ndërtim kapacitetesh dhe në llogaridhënien për realizimin e nismës.
- Zbatimi i nismës “Shkolla si qendër komunitare” kërkon rishikime sistematike, kërkon politika dhe procedura të artikuluar qartë gjë që nuk mund ta bëjnë vetë shkollat me kapacitetet që ato kanë. Do të ishte shumë ndihmuese për shkollat që t’u ofrohej ekspertizë dhe asistencë teknike për realizimin e nismës. Për të siguruar këtë asistencë do të duhej bashkëpunimi i universiteteve, i agjencive dhe organizatave që kanë përvojë në bashkëpunimin e shkollës me komunitetin.

### **Ekipi koordinues i SHQK në shkollë**

- Është e rëndësishme të sqarohet qartë mekanizmi i shpërblimit financiar të mësuesve dhe koordinatorëve të cilët do të angazhohen në aktivitetet në kuadër të SHQK-së pasi ajo që vihet re aktualisht referuar perspektivës së mësuesve dhe koordinatorëve është se ka një konfuzion lidhur me shpërblimin financiar.
- Në rast se mungon motivimi i mësuesve ekzistues edhe kundrejt incentivit financiar (sic rezultoi në disa prej fokus grupeve të realizuara), të ftohen mësues apo profesionistë të tjerë ose studentë praktikantë (të mësuesisë apo psikologjisë), sidomos në ato zona në të cilat ka universitete, për t’u angazhuar dhe kontribuar në këtë drejtim. Këta persona mund të mbulojnë një ose dy shkolla SHQK dhe të nxisin aktivitetet në këtë drejtim. Në rastin e përfshirjes së studentëve praktikantë, kjo kërkon paraprakisht një ngritje kapacitësh nëpërmjet një cikli trajnimi intensiv si edhe një bashkëpunim të ngushtë me universitetet në mënyrë që të sigurohet vijimësia.
- Organizimi i takimeve apo grupeve të diskutimit me ekipet koordinuese të SHQK në nivel DAR/ZA për të qartësuar dhe nxitur një të kuptuar më të saktë të rolit dhe përgjegjësisë që ata kanë në kuadër të kësaj nisme. Këto takime, duhet të synojnë që ekipet koordinuese të kuptojnë rolin e tyre si katalizatorë të krijimit të një partneriteti të vërtetë shkollë-familje-komunitet; apo si një hallkë e rëndësishme që është e supozuar të sjelli bashkë të gjithë aktorët me qëllim realizimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK, dhe jo si të vetmit persona përgjegjës.
- Është e nevojshme që ekipet koordinuese të SHQK në shkollë të trajnohen në vazhdimësi dhe të mbështeten me materiale burimore, udhëzues, paketa dhe instrumente që ndihmojnë

në kuptimin dhe përmbushjen e rolit të secilit aktor në realizimin e nismës SHQK, në ndarjen e përgjegjësisë, në zhvillimin e një dialogu ndërmjet gjithë të interesuarve; në krijimin e një partneriteti të vërtetë shkollë-familje-komunitet. Gjithashtu, gjatë trajnimeve me këto ekipe vlen të ritheksohet rëndësia që ka përdorimi në mënyrë kreative apo në përshtatje me situatën e shkollës përkatëse të materialeve të ndryshme burimore dhe jo përdorimi i tyre në mënyrë shabllone e skematike.

- Mbështetja përgjatë punës e ekipit koordinues të SHQK, nëpërmjet seancave të supervizimit do të ishin një aspekt pozitiv që do të kontribonte në përmirësimin e aftësive të këtij ekipi për të zbatuar në mënyrë cilësore aktivitetet e SHQK. Seancat e supervizimit mund të realizohen nga psikologë/punonjës social të shkollës, koordinatorë SHQK në DAR/ZA. Këto séanca duhet të synojnë orientimin e këtij ekipi hap pas hapi më tepër në procesin e përfshirjes dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët në fazat e identifikimit të nevojave, planifikimit dhe konceptimit të aktiviteteve për t'i adresuar sa më mirë nevojat e identifikuara. Këto dy faza kanë rezultuar më sfiduese për shkollat, sepse përsa i përket fazës së zbatimit të aktiviteteve në praktikë ekipet koordinuese performojnë mirë.
- Duhet të nxiten brenda shkollës realizmi i takimeve periodike vetëvlerësuese të aktorëve të shkollës të përfshirë drejtpërdrejtë në zbatimin e SHQK. Këto takime duhet të kenë formën e reflektimeve ku anëtarët e ekipit të diskutojnë me njëri-tjetrin në lidhje me ato që kanë vajtur mirë dhe ato që nuk kanë funksionuar ashtu siç duhet; pikave të forta dhe të dobëta të procesit; si edhe të nxjerrin mësim nga eksperiencia e kaluar. Kjo do të ndihmonte së tepërmi në një zbatim më cilësor të nismës.
- Pavarësisht se mbështetja financiare për realizimin e aktiviteteve në kuadër të SHQK nuk duhet të perceptohet si faktori kryesor që mundëson ose jo realizimin e aktiviteteve - është e nevojshme që ekipet koordinuese të trajnohen për të ngritur fonde për të mbështetur veprimtaritë e ndryshme në kuadrin e SHQK.

### **Bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve**

- Bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve, këto dy organizma të shkollës që me akte ligjore dhe nënligjore kanë role shumë të rëndësishme në vendimarrje, rezultojnë të kënaqur në realitet një rol minimal. Në këtë kuadër nevojitet ngritja apo forcimi i kapaciteteve të bordit të shkollës dhe këshillit të prindërve, nëpërmjet ëorkshopeve periodike, të cilat të kenë në fokus të tyre mobilizimin e komunitetit, përfshirjen e prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit në vendimarrje në institucionin arsimor.
- Nxitja e takimeve periodike të bordit të shkollës, këshillit të prindërve dhe ekipit koordinues të shkollës për SHQK për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive që lidhen me “shkollën si qendër komunitare”.

## Mësuesit:

- Duhet bërë trajnime në vazhdimësi me mësuesit e shkollave pjesë të SHQK. Këto trajnime duhen bërë si me mësuesit drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të SHQK, ashtu sikurse edhe me mësuesit të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejtë. Këto trajnime duhet të fokusohen:
  - a. Në dimensione dhe aspekte të caktuara të nismës që pasurojnë njohjen, ofrojnë metodologji të efektshme dhe zhvillojnë reflektimin.
  - b. Në të kuptuarit e shkollës si komunitet i të nxëniet. Rëndësinë dhe vlerën afatgjatë që ka kjo iniciativë për nxënësit, mësuesit, prindërit, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.
  - c. Në modelet e efektshme të SHQK.
  - d. Në modelet e partneritetit shkollë-komunitet.

Sa më mirë që mësuesit dhe aktorët e tjerë të shkollës ta kuptojnë dhe realisht ta “përqafojnë” apo brendësojnë çështjet e renditura më sipër, aq më mirë do kuptojnë dhe interpretojnë rolin e tyre, aq më kreativë do të jenë në konceptim dhe realizim duke shmangur kështu të kuptuarit mekanik apo të bërit thjesht të një detyre.

## Prindërit/komuniteti

Përfshirja e prindërve dhe komunitetit varet së tepërmi nga: vlerat që aktivitetet e realizuara kanë për fëmijët dhe familjet; nga përfshirja reale e tyre në vendimarrje (sidomos në identifikimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve në të mirë të fëmijës dhe gjatë zbatimit e tyre); si edhe nga perceptimi që ata kanë mbi atë se çfarë i duhet një fëmije/të riu që të rritet mirë në aspektin fizik, psikologjik, emocional dhe social. Në këtë kuadër:

- Është mirë të realizohen workshope sensibilizuese me prindër dhe anëtarë komuniteti për të shpjeguar filozofinë e SHQK, përfitimet që fëmijët/nxënësit do të kenë nëse aktorë të ndryshëm vijjnë bashkë dhe kontribuojnë në forma të ndryshme për mirëqënien e fëmijëve. Këto workshope duhet gjithashtu të tejkëojnë idenë se *“çdokush në komunitet mund të luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë të rriten mirë dhe në mënyrë të shëndetshme”*. Në mënyrë që këto workshope të japin efektet e tyre duhet të jenë të mirë-planifikuara dhe të realizohen në vazhdimësi.

- Këto workshope rekomandohen të realizohen nga ekipi koordinues i SHQK në shkollë. Por nga ana tjetër kërkohet që ky grup të ketë një mbështetje të gjerë si nga pjesa tjetër e mësuesve si edhe nga drejtorja e shkollës.
- DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore duhet të zhvillojnë strategji që nxisin përfshirjen dhe angazhimin vullnetar të familjarëve dhe pjesëtareve të komunitetit në veprimtaritë që organizon shkolla dhe përmirësimin e cilësisë së saj.

### **Nxënësit**

- Në përgjithësi qeveritë e nxënësve kanë luajtur një rol aktiv në kuadër të SHQK. Megjithatë nevojitet që ato të angazhohen për të përfshirë sa më shumë nxënës të shkollës në procesin e identifikimit të nevojave, planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve.
- Rekomandohet realizimi i trajnimeve vetëm me qeveritë e nxënësve nga DAR/ZA dhe koordinatorët e shkollës për SHQK në mënyrë që të kuptohet drejt roli i tyre si një prej aktorëve të cilët duhet të shërbejnë si urë lidhëse për gjithë komunitetin e nxënësve të shkollës.
- Të realizohen workshope sensibilizuese me bazë shkolle për të gjithë nxënësit me qëllim shpjegimin e konceptit dhe filozofisë së SHQK, vlerat dhe rëndësinë që ka kjo nismë për nxënësit vet, për familjarët e tyre, si edhe për gjithë komunitetin në përgjithësi. Në këto workshop-e nxënësit duhet të inkurajohen që të ndajnë me prindërit e tyre konceptin, rëndësinë dhe aktivitetet në kuadër të SHQK – pasi nxënësit vet janë faktorët më ndikues në përfshirjen e prindërve në këtë nisëm. Këto workshope duhet të planifikohen për t'u realizuar në vazhdimësi nga ekipi koordinues i SHQK në shkollë (të trajnuar paraprakisht).

### **Konceptimi, planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve**

- Propozimet lidhur me aktivitetet të merren nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit (komuniteti) duke mundësuar së pari krijimin e një grup propozimesh prej të cilave të përzgjidhen ato që përmbushin më së miri interesin dhe nevojat e nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Të gjitha propozimet duhen diskutuar në detaje me nxënësit/prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të sigurohet maksimalisht pjesëmarrja në vendimarrje. Sa më tepër kohë t'i dedikohet këtij aspekti, sa më shumë diskutime paraprake të ketë aq më shumë pjesëmarrje aktive të vetëdijshme do të ketë nga të gjitha palët. Në këtë kuadër faza e diskutimeve dhe përfshirjes së palëve duhet të konsiderohet si orë aktiviteti për mësuesit e përfshirë në to.

- Në secilin aktivitet të propozuar duhet përmbushur kriteri i përfshirjes dhe fuqizimit të më të varfërve, të përjashtuarve. Këto grupime duhet të kenë një zë të qartë dhe më aktiv në konceptimin, planifikimin, realizimin e aktiviteteve dhe jo të jenë thjesht përfitues nga aktivitetet.
- Meqënëse nisma është ende në fillimet e saj, me qëllim formimin e modeleve pozitive është e rekomandueshme që numri i nevojave/interesave për tu adresuar të jetë i vogël, por me ndikim të gjerë tek të gjithë palët. Gjithashtu, aktivitetet e përzgjedhura duhet të realizohen me cilësinë maksimale dhe nëpërmjet partneritetit shkollë-familje-komunitet.
- Meqë planifikimi i nevojave, interesave dhe prioriteteve përcakton llojin e veprimtarive, shkollat e përfshira në SHQK nuk i ngjajnë njëra-tjetrës si për çështjet që zgjedhin të adresojnë ashtu edhe për mënyrën se si e realizojnë në praktikë (edhe nëse çështja është e njëjtë).

### **Shkëmbimi i eksperiencave pozitive**

- Pas krijimit të disa modeleve të qarta pozitive si në konceptimin, planifikimin dhe zbatim të aktiviteteve është e rekomandueshme shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet shkollave ku protagonistët kryesorë (mësue/nxënës/prindër/biznesi, OJF) të ndajnë perspektivën e tyre (vështirësitë, sfidat, pikat e forta, mësimet e nxjerra).
- Për këtë mund të përdoret edhe portali online i SHQK që pritet të promovohet së shpejti nga MAS.

### **Bashkëpunimi me institucione e nivelit qendror, nivelit lokal dhe OJF**

- Në dobi të nismës do të ishte formalizimi i bashkëpunimeve të shkollës me institucione të tjera të nivelit qendror dhe lokal (mundësisht nëpërmjet marrëveshjeve apo memorandumeve të bashkëpunimit). Vet shkolla (drejtuesi i shkollës) duhet të angazhohet për të realizimin e këtyre marrëveshjeve; në ato raste kur hasin vështirësi duhet të kërkojnë mbështetjen e DAR/ZA ose MAS nëse nevojitet.
- Gjithashtu, një planifikim i mirë vjetor për SHQK nga ana e shkollës duhet të përmbajë (në ato raste kur vlerësohet e nevojshme), parashikimin e realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione lokale apo qendrore. Kjo do të mundësojë marrjen e masave paraprakisht për vënien në jetë të këtyre marrëveshjeve.

- Bashkëpunimi i institucioneve arsimore me pushtetin vendor do të ishte me tepër vlerë duke qenë se bashkia ka mandatin dhe buxhetin në nivel vendor dhe mundet të kontribuojë në kuadër të “shkollës si qendër komunitare”. Për këtë nevojiten së pari takime informuese për struktura e pushtetit vendor mbi qëllimin, filozofinë e SHQK, vlerën që ka kjo nisim për fëmijët, prindërit dhe komunitetin në përgjithësi dhe më pas krijimi i urave të vërteta të bashkëpunimit duke i bërë përfaqësuesit e pushtetit vendor pjesë të ekipeve koordinuese të SHQK.
- Është i rekomandueshëm bashkëpunimi me organizata joqeveritare ose ente të tjera publike ose private për mbështetjen financiare dhe logjistike të aktiviteteve. Shkollat të cilat do të bashkëpunojnë nuk duhet të përzgjedhin aktivitetet bazuar në interesat e organizatave, por në interesat e nxënësve/prindërve dhe komunitetit. Në pamundësi sugjerohet “matching approach” ku organizatat financojnë disa aktivitetet të përzgjedhura nga nxënësit/prindërit dhe komuniteti, ndërkohë që shkolla krijon hapësirë për organizatat që të realizojnë dhe axhendën/aktivitetet prioritare për to.
- MAS dhe IZHA mund të kujdesen për të përfshirë aktivisht universitetet për të dhënë ekspertizë dhe asistencë teknike për SHQK duke formalizuar bashkëpunimin ose duke u ofruar atyre mundësi konkurrimi për të realizuar projekte të ndryshme në kuadër të SHQK.

### **Infrastruktura**

- Atje ku është e mundur sugjerohet të përmirësohet infrastrukture në shkollat e përzgjedhura në kuadër të SHQK-së. Kjo do të ndikojë si në zgjerimin e gamës së aktiviteteve që mund të bëjë shkolla ashtu edhe në cilësinë e tyre.

### **DAR/ZA**

Për të përmirësuar veprimtarinë e DAR/ZA lidhur me SHQK rendisim këtë grup rekomandimesh.

- Të organizojnë takime në bazë shkolle me gjithë mësuesit që aktivizohen në kuadër të SHQK ku të risqarohen për formën e raportimit dhe shpeshësinë e tij.
- Duhet hartuar forma të thjeshta raportimi mbi aktivitetet e realizuara në mënyrë që energjia dhe koha e mësuesve të fokusohet tek ideimi dhe realizimi i aktiviteteve cilësore me qendër nxënësin dhe jo tek vetë procesi i raportimit.
- Rekomandohet të ndryshojë perceptimi mbi raportimin në kuadër të SHQK. Raportimi duhet të ketë shumë më shumë qëllim dokumentin e procesit se sa kontrollin dhe vlerësimin e performancës së mësuesve në kuadër të SHQK.

- Trajnime për të krijuar evidencë dhe përgatitur raporte mbi bazën e të cilave do të merren vendime për ecurinë e projektit do të ishte një ndihmë për koordinatorët e DAR/ZA që më pas do të tej conin këtë informacion në shkollat përkatëse.
- Për matjen e performancës së shkollës në kuadër të SHQK rekomandohet të shihet mundësia e përfshirjes së disa pyetjeve që lidhen drejtëpërdrejtë me SHQK në pyetësorët që mbledhin informacion nga prindërit, nxënësit dhe mësuesit në kuadër të “Kartës së Performancës”.
- Për të kuptuar ndikimin e aktiviteteve të SHQK mbi grupet përfituese duhet vlerësuar në mënyrë periodike perspektiva e përfituesve (nxënës/prindër/komunitet). Duhet të jenë përfituesit që vlerësojnë aktivitetet dhe cilësinë e tyre nëpërmjet organizimit të fokus grupeve me nxënës, prindër dhe mësues të zgjedhur në mënyrë rastësore. Këto fokus grupe mund të realizohen nga partner të jashtëm të shkollës, por edhe nga struktura brenda shkollës si qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve, apo bordi i shkollës. Në këtë mënyrë sigurojmë një mekanizëm fedbacku i cili jo vetëm do të na tregojë mbi cilësinë e nismës, por dhe do të ndihmojë shumë për të kuptuar ato aspekte që duhen përmirësuar. Gjithashtu vlerësimi i perspektivës së palëve përfituese do të rrisë nivelin e tyre të përfshirjes, transparencën dhe presionin pozitiv.
- DAR/ZA duhet të angazhohen për të lehtësuar, koordinuar dhe formalizuar bashkëpunimin e institucioneve arsimore me pushtetit vendor (bashkia), bizneset lokale, institucione të tjera të nivelit qendror, OJF etj.



## 7. REFERENCA

American School and University Magazine – [www.asumag.com](http://www.asumag.com)

Benson, P.L. (2006) All kids are our kids: What communities must do to raise caring and responsible children and adolescents (2nd Ed.). San Francisco: Jossey-Bass.

Broader Bolder Coalition Component Programs – Executive Summary

Building Educational Success Together (BEST) – [www.21csf.org/csf-home/best/best.asp](http://www.21csf.org/csf-home/best/best.asp)

Children’s Aid Society – [www.childrensaidsociety.org](http://www.childrensaidsociety.org)

Coalition for Community Schools – [www.communityschools.org](http://www.communityschools.org)

Dokumenti i Strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (draft)

George Lucas Educational Foundation: (Re)Designing Learning Environments – [www.edutopia.org/redesigning](http://www.edutopia.org/redesigning)

Letër sqaruese e MAS për funksionimin e shkollës si qendër komunitare, datë 31.03.2014. drejtuar DAR/ZA

National Clearinghouse for Educational Facilities – [www.edfacilities.org](http://www.edfacilities.org)

New Schools Better Neighborhoods (NSBN) – [www.nsbns.org](http://www.nsbns.org)

School Planning and Management Magazine – [www.peterli.com/spm](http://www.peterli.com/spm)

Schools as Centers of Community: A National Search for Excellence – [www.nationalschoolsearch.org](http://www.nationalschoolsearch.org)

Small, Mark (2015) Approaches to Community and School Relationships

Smart Schools, Smart Growth Initiative – [www.smart-schools.org](http://www.smart-schools.org)

Standardet e shkollës si qendër komunitare, miratuar nga MAS më 13.03.2014

Udhëzim i MAS Nr.44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH Nr.21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”

University of Kansas Community Toolbox website – provides a practical and convenient resource that was useful for analyzing in our context with the necessary adaptations.

Urdhër MAS Nr. 464, datë 01.11.2013 “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e projektit “shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”

## Aneks A

### Guida e Fokus Grupeve

<p>1. Qëllimi i fokus grupit</p> <p><i>“Ne jemi mbledhur sot të diskutojmë së bashkë idenë e shkollës si qendër komunitare. Cilat janë mendimet/opionet e juaja në lidhje me këtë gjë? Cilat janë avantazhet? Si po funksionon zbatimi i kësaj iniciative në praktikë? A keni hasur në vështirësi? Cfarë gjërash mund të përmirësohen?”</i></p>
<p>2. Mendoni në lidhje me shkollën tuaj dhe komunitetin</p> <p>Ndërgjegjësimi dhe kuptimi mbi iniciativën SHQK:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Cilat janë karakteristikat e një shkollë që shërben si qendër komunitare (SHQK)? (pjesëmarrësit nxiten të listojnë sa më shumë karakteristika të SHQK)<ul style="list-style-type: none"><li>○ <i>Probing questions në lidhje me 5 fushat kryesore të standarteve:</i><ol style="list-style-type: none"><li>1. <i>Edukim cilësor për të gjithë nxënësit</i></li><li>2. <i>Mirëqënia fizike, emocionale dhe sociale për të gjithë nxënësit</i></li><li>3. <i>Përfshirja e komunitetit</i></li><li>4. <i>Vendimmarrje e përbashkët</i></li><li>5. <i>Gjithëpërfshirje dhe respect për diversitetin</i></li></ol></li></ul></li><li>• Cilët janë aktorët kryesorë të përfshirë? Kush janë rolet dhe përgjegjësisë e tyre?<ul style="list-style-type: none"><li>○ <i>Probing questions:</i><ol style="list-style-type: none"><li>1. <i>Cili ka qenë roli/ kontributi juaj konkret (si mësues/ prindër/ nxënës)</i></li><li>2. <i>Cila është marrëdhënia midis shkollës dhe komunitetit? Cfarë principesh e drejtojnë këtë marrëdhënie?</i></li><li>3. <i>Si mundet që shkolla juaj ti shërbejë komunitetit (a resource for your community)</i></li><li>4. <i>Si mundet që komuniteti ti shërbejë shkollës (community be a resource for your school?)</i></li></ol></li></ul></li></ul> <p>Statusi i zbatimit në praktikë të standarteve të SHQK:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pjesëmarrësit prezantohen me listën e 5 fushat dhe standartet për secilën prej fushave...Pjesëmarrësit nxiten të diskutojnë secilin prej standarteve bazuar në sa më poshtë:</li><li>• Është i kuptueshëm, është i aplikueshëm për kontekstin shqiptar, për komunitetin tuaj dhe si zbatohet në praktikë?</li><li>• Nëse “JO”:<ul style="list-style-type: none"><li>○ Pse? Cilat janë arsytet? Cilat janë pengesat/barrierat?</li><li>○ Cfarë nevojitet të ndryshojë? Cfarë duhet?</li><li>○ Cfarë rekomandoni/sugjeroni ju?</li></ul></li><li>• Nëse “PO”:<ul style="list-style-type: none"><li>○ Cilat janë disa aktivitete konkrete që shkolla juaj si qendër komunitare ka zhvilluar (në lidhje me standartin përkatës)?</li><li>○ Si janë identifikuar nevojat? Si janë planifikuar aktivitetet? <i>Aktorët kryesorë:</i> Kush</li></ul></li></ul>

<p>ka qenë i përfshirë në identifikimin e nevojave dhe në planifikimin e aktiviteteve?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Si janë zbatuar në praktikë këto aktivitete? Si janë monitoruar? <i>Aktorët kryesore:</i></li> <li>○ Cilët kanë qenë të përfshirë në implementim dhe monitorim e aktivitetit?</li> <li>○ Cilat kanë qenë vështirësitë kryesore / sfidat gjatë këtij procesi?</li> <li>○ Cilat janë rezultatet e këtyre aktiviteteve? Pra çfarë impakti, çfarë efekti kanë patur këto aktivitete?</li> <li>○ Çfarë ka vajtur mirë / ka funksionuar mirë? Cili ka qenë çelësi i suksesit?</li> <li>○ Kush ka përfituar nga këto aktivitete? Në çfarë mënyre kanë përfituar? Cilat janë qenë përfitimet për shkollën, për aktorët e saj, për komunitetin?</li> <li>○ Çfarë do të bënit ndryshe nëse do të kishit mundësinë që ti bënit përsëri këtë/këto aktivitete? Çfarë rekomandoni/sugjeroni, çfarë këshille jepni ju?</li> <li>○ Çfarë mësimesh keni nxjerrë nga ky process (realizimi i aktiviteteve konkrete në kuadër të SHQK)</li> </ul>
<p>SHQK inkurajon edukimin gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me fokus të vecantë tek ata që janë më vulnerabël...</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>● A kanë përfituar grupet në nevojë të komunitetit tuaj nga aktivitetet në kuadër të SHQK? (e.i. grupe minoritare, të varfërit, nxënëit me aftësi të kufizuara etj.)</li> <li>● Nëse “JO” – Përse? Cilat janë arsyet?</li> <li>● Nëse, “PO” – Në çfarë mënyre kanë përfituar?</li> <li>● Në rast se shkolla juaj nuk do të ishte pjesë e iniciativës SHQK – a do të kishin përfituar njësoj grupet vulnerabël????</li> <li>● Në çfarë mënyre iniciativa SHQK – bën më mirë të mundur adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël?</li> <li>● Çfarë nevojitet të bëhet më shumë në këtë aspekt?</li> <li>● Çfarë mësimesh keni nxjerrë në këtë drejtim?</li> </ul>
<p>Transformimi I shkollës në një qendër “të vërtetë” komunitare</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>● Procesi i transformimit të shkollës në një qendër komunitare: Çfarë duhet për ta kthyer/transformuar shkollën në një qendër komunitare “të vërtetë”....?</li> <li>○ <i>Probing questions:</i> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë nevojitet/ çfarë duhet që ky process të zbatohet ashtu sic duhet në praktikë, të ketë sukses?</li> <li>2. Cilat janë vështirësitë kryesore?</li> <li>3. Cilat janë disa pika të forta/ aspekte pozitive që shkolla/ komuniteti juaj i ka që mund të ndihmojnë për ta çuar më përpara këtë process (SHQK)</li> <li>4. Cilat janë disa disavantazhe/ pika të dobëta të shkollës/ komunitetit tuaj të cilat mund ta afektojnë/ pengojnë/ vështirësojnë këtë process?</li> </ol> </li> </ul>

5. A mund të mendoni për mënyra të ndryshme/alternative se si komuniteti të përfshihet më tepër në shkollë dhe të mbështesi më tepër shkollën?
6. Po mënyra të tjera se si shkolla të përfshihet dhe të mbështesi më shumë komunitetin?

- Cila është vlera e shtuar e kësaj “lloj shkolle” SHQK për komunitetin tuaj?
- Cilat janë përfitimet e aktorëve të ndryshëm nga SHQK: (Prindërit; Mësuesit; Nxënësit; Komuniteti; Biznesi; Pushteti vendor)
- Si e kuptojnë/ si e kanë kuptuar mësuesit e tjerë (prindërit/nxënësit/anëtarët e komunitetit) SHQK? Cfarë mendojnë ata për SHQK?
- Cfarë mund të jetë diçka që ti bëj të gjithë aktorët të bashkëpunojnë/ të kontribuojnë? Pse duhet që ata të vijnë bashkë?

Ju faleminderit!

## Aneks B

### Guida e intervistave gjysëm të strukturuar

Statusi i zbatimit në praktikë të standarteve të SHQK:

- A janë standartët e SHQK të aplikueshme për zonën tuaj
- Nëse “disa nuk janë dhe aq të aplikueshme” apo nuk kanë shumë relevancë kulturore:
  - Cilat janë këto standarte?
  - Përse? Cilat mund të jenë arsyet? Cilat janë barrierat/vështirësitë?
  - Cfarë mund të ndryshohet?
  - Cfarë do të rekomandoni, sugjeroni ju?
  - Si mund ti riformulojmë, ndryshojmë këto standarte?
- Nëse “PO, disa/të gjitha janë të aplikueshme”
  - Cilat janë disa aktivitete konkrete në kuadër të SHQK që janë aplikuar në DAR/ZA tuaj
  - Si janë planifikuar, implementuar dhe monitoruar këto aktivitete
  - Kush ka qenë i përfshirë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre
  - Cilat kanë qenë sfidat, vështirësitë më të mëdha gjatë këtij procesi?
  - Cfarë ka funksionuar mirë? Cili ka qenë çelësi i suksesit?
  - Kush ka përfituar nga këto aktivitete? Në çfarë mënyre kanë përfituar? Cilat janë përfitimet e shkollës dhe komunitetit?

Përfshirja e komunitetit

- Cila është marrëdhënia midis shkollës dhe komunitetit? Cfarë principesh e drejtojnë këtë marrëdhënie?
- Cilat janë key stakeholders në komunitetin tuaj? Kush tjetër duhet të përfshihet, por në fakt nuk është përfshirë/ nuk ka qenë aktiv
- Po grupet vulnerabël (Romë/ të varfër, etj...) sa të përfshirë janë?
- Cilat janë qendrimet e aktovorëve të ndryshëm lokal në lidhje me SHQK?
- Cfarë mënyrash sugjeroni ju – me qëllim përfshirje e komunitetit më tepër në këtë iniciativë? Po shkolla si mund të angazhohet/përfshihet më shumë për të mbështetur komunitetin?

Financimi

- Cila është situata e financimit të kësaj iniciative?
- Cilët mund të jenë kontribuesit kryesor për të financuar dhe mbështetur SHQK?
- Po komuniteti si mund të mbështesi përpjekjet e shkollës për të ngritur fonde?

SHQK inkurajon edukimin gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me fokus të vecantë tek ata që janë më vulnerabël...

- A kanë përfituar grupet në nevojë të komunitetit tuaj nga aktivitetet në kuadër të SHQK? (e.i. grupe minoritare, të varfërit, nxënëit me aftësi të kufizuara etj.)
- Nëse “JO” – Përse? Cilat janë arsytet?
- Nëse, “PO” – Në çfarë mënyre kanë përfituar?
- Në çfarë mënyre iniciativa SHQK – bën më mirë të mundur adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël?
- Çfarë nevojitet të bëhet më shumë në këtë aspekt?

Procesi I transformimit të shkollës në një qendër “të vërtetë” komunitare

- Çfarë duhet që shkolla të transformohet në një qendër komunitare të vërtetë?
  - Çfarë nevojitet që ky process të ketë sukses?
  - Cilat janë sfidat kryesore?
  - Cilat janë pikat e forta (në nivele të ndryshme: individual, familja, shkolle, komuniteti, nivel institucional etj.) që ndikojnë në këtë process?
  - Cilat janë disavantazhet, pikat e dobëta (në nivele të ndryshme: individual, familja, shkolle, komuniteti, nivel institucional etj.) që ndikojnë në këtë process?

Përfitimet nga SHQK

- Cilat është vlera e shtuar e SHQK për komunitetin tuaj? Çfarë difference ka sjellë apo mund të sjelli iniciativa SHQK për komunitetin/zonën tuaj?
- Cilat do të ishin përfitimet e aktorëve të ndryshëm nga SHQK?
- Nëse do të krahasonit situatën e nxënësve/familjeve/ shkollës/ komunitetit përpara zbatimit të iniciativës SHQK dhe tani – cilat janë ato diferenca/ndryshime që mund të identifikoni?

Drejtimet për të ardhmen:

- Çfarë mësimesh keni nxjerë deri tani – pra nga zbatimi në praktikë I kësaj initiative?
- Çfarë do të rekomandonit ju që iniciativa SHQK të zbatohet në mënyrë të suksesshme në zonën tuaj/ në zona të tjera?

### Aneksi C

Lista e shkollave sipas rretheve përkatëse që u përzgjedhën për intervistat dhe fokus-grupet në kuadër të vlerësimit të iniciativës “Shkolla si Qendër Komunitare”

Vlorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Ali Demi”</li> <li>• "Ibrahim Kushta" - 9 –vjecare</li> <li>• “Ismail Qemali” – 9-vjecare</li> </ul>
Tiranë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkolla e kuqe – 9 vjecare</li> <li>• Petro Nini Luarasi – e mesme</li> <li>• Shkolla Vorë – 9 vjecare</li> <li>• Shkolla Yzberisht – 9 vjecare</li> </ul>
Korçë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Sotir Gura” 9-vjecare</li> <li>• "Th. Germenji" – e mesme</li> <li>• "Naum Veqilharxhi" -9-vjecare</li> <li>• "Ismail qemali" - 9-vjecare</li> </ul>
Përmet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 9-vjecare " Nonda Bulka"</li> <li>• 9-Vjecare" Kamber Benja"</li> <li>• ShMB "Lumo Pavari"</li> </ul>
Shkodër	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “28 Nentori” – e mesme</li> <li>• " Azem Hajdari" - 9 vjeçare</li> <li>• " Tringë Smajli" - 9-vjecare</li> </ul>
Tropojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 9-vjecare " Ali Podrimja"</li> <li>• 9-vjecare " Beslidhja malsise"</li> <li>• 9-vjecare" Konferenca Bujanit"</li> </ul>
Durrës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkolla 9vjecare Demokracia</li> <li>• Shk. 9 vjeçare “Hasan Koçi”</li> <li>• Shkolla e mesme Manzë</li> <li>• Shkolla 9 vjeçare Maminas</li> </ul>
Elbasan	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mehmet Bajraktari - E mesme e Bashkuar</li> <li>• Mahir Domi – Gjinnaz</li> <li>• "Hamit Mullisi" 9-vjeçare</li> </ul>
Dibër	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Irfan Hajrullai – 9-vjeçare</li> <li>• Seit Najdeni - e mesme</li> <li>• Idris Kaba - 9-vjeçare ne Tomin</li> </ul>